



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 420 Akti

Nr. 557 Vendimi
Tiranë, më 29.07.2022

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në datat 11.5.2022 dhe 27.7.2022, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancat dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Emiljano Ruli**, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi në seancat dëgjimore subjektin e rivlerësimit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

i. Z. Emiljano Ruli, është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, z. Emiljano Ruli, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine (relatore).

iii. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit¹, raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar(në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

iv. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues, komisionerin Olsi Komici dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

v. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Emiljano Ruli, bazuar në kriterin e rivlerësimit të pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe rivlerësimit të figurës referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

vi. Në datën 12.4.2022 subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për kriterin e pasurisë, duke e njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve për të provuar të kundërtën e barrës së provës dhe afatin e ushtrimit të këtyre të drejtave.

I. SEANCA DËGJIMORE

vii. Në datën 11.5.2022, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

a) Pas përfundimit të seancës dhe pasi vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, si dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit njoftoi riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe çeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Emiljano Ruli.

b) Në datën 13.7.2022 subjektit iu dërguan rezultatet shtesë të hetimit administrativ për kontrollin e pasurisë, si dhe rezultatet e hetimit administrative për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke e njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve për të provuar të kundërtën e barrës së provës dhe afatin e ushtrimit të këtyre të drejtave.

c) Në datën 27.7.2022 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore në prani të subjektit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca për shpalljen e vendimit të trupit gjykues u zhvillua në datën 29.7.2022.

¹Vendimi i GjEDNj-së, Xhoxhaj kundër Shqipërisë, 9 shkurt 2021, në paragrafin 333 citohet: []“Gjykata vëren se Komisioni kishte juridiksion të plotë për të gjitha çështjet faktike dhe ligjore. Ajo u krijua posaçërisht për të interpretuar dhe zbatuar ligjin nr. 84/2016. Vlerësimi i fakteve kërkonte vërtet njohuri të specializuara ose përvojë specifike profesionale, prandaj ligji nr. 84/2016 tregon institucionet ndihmëse që do të ndihmonin Komisionin në kryerjen e detyrave të tij. Kjo theksohet, gjithashtu, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila shtoi, me tej, se vendimarrja përfundimtare do t'i takonte Komisionit ... []”.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/ HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. Vlerësimi i pasurisë

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese kryer lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/20173 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi si vijon:

1. Apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 119.3 m², rruga “****” Tiranë

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar për këtë pasuri kontratë porosie nr. *** prot, datë 12.11.2009, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k, ku subjekti në cilësinë e blerësit dhe shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e shitësit kanë rënë dakord të lidhin kontratën premtim shitje për sendin e ardhshëm apartament banimi me sipërfaqe totale 119.3 m², me çmim 9.000.000 lekë, me adresë rruga “****”, Tiranë.

1.2. Burimi i deklaruar i blerjes së kësaj pasurie të paluajtshme nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* janë:

- i) tërheqje nga “Raiffeisen Bank” e llogarisë së pagës së bashkëshortes V.R në vlerën 800.000 lekë;
- ii) tërheqje e depozitës së subjektit në vlerën 700.000 lekë, vlerë *cash* e grumbulluar nga kursimet;
- iii) hua nga shtetasi A.Z në shumën 4.000.000 lekë me kontratën e huas nr. ***, datë 7.12.2009;
- iv) hua verbale në shumën 3.000.000 lekë dhënë nga babai Sh.R.

1.3. Në DVP-në e vitit 2009, subjekti, në ndryshimet e interesave, ka deklaruar: kontratë porosie për blerje apartamenti në vlerën 9.000.000 lekë, parapaguar shuma 8.631.500 lekë, shoqërisë “****” sh.p.k., me burim krijimi: mbarimin e depozitës bankare, tërheqje *cash* të vlerës 714.900 lekë; kontratë huaje në vlerën 4.000.000 lekë, me huadhënës z. A.Z, me qëllim blerje apartamenti; hua pa afat në vlerën 3.000.000 lekë, nga babai Sh.R, me qëllim blerjen e apartamentit; tërheqje *cash* në vlerën 800.000 lekësh, nga llogaria e pagesës së bashkëshortes për blerje apartamenti.

1.4. Sipas nenit 3 të kontratës së porosisë nr. *** prot., datë 12.11.2009, blerësi ka parapaguar vlerën prej 8.631.500 lekësh dhe shuma prej 368.500 lekësh do të paguhet me marrjen në dorëzim të apartamentit dhe nënshkrimin e autorizimit të dorëzimit të çelësave, parashikuar brenda datës 30.12.2009. Pagesat që do të kryhen nga blerësi do të vërtetohen me faturat e transfertave bankare (neni 3.4 i kontratës).

1.5. Lidhur me pagesën e këstit të dytë në shumën prej 368.500 lekë, subjekti i rivlerësimit në deklaratën vjetore të vitit 2009 dhe viteve në vijim nuk ka deklaruar detyrime ndaj të dhe viteve në vijim, si detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k, duke mos përmbushur detyrimet e parashikuara nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

1.6. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti, pyetur, lidhur me mënyrën e pagesës së çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...mënyra e pagesës ndaj shoqërisë ‘****’ sh.p.k. është bërë me para në dorë, në kushte të informalitetit të tregut. Duke qenë se vlera e likuiduar ka qenë shënuar në kontratë, nga shoqëria nuk me kujtohet nëse më është lëshuar apo jo dokument tjetër shtesë për pagesën”.

1.7. Lidhur me pagesën e këstit të dytë në vlerën 368.500 lekë dhe kohën e pagimit të tij, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se: “...shuma e këstit prej 368.500 lekësh, nuk është përfshirë në DVP-në e vitit 2009 në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, pasi nuk përcaktohej nga ligji i kohës si kredi, huamarrje, detyrim për studime. Kjo shumë është paguar gradualisht ndër vite, me këste të vogla të cilat ligji i kohës nuk i përcaktonte si shpenzime të deklarueshme dhe as kishte përcaktuar vlerën minimale të tyre. Burimi i të ardhurave i përdorur për këtë shpenzim kanë qenë tërheqje periodike ndër vite nga llogaria bankare e pagesës sime dhe e bashkëshortes...”.

1.8. Nisur nga fakti që subjekti në DPV-në e vitit 2009 nuk ka deklaruar, në formularin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizike, detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., Komisioni ka vlerësuar se për efekt të analizës financiare shuma prej 368.500 lekësh do të llogaritet e shlyer në periudhën 13.11.2009 – 31.12.2009.

Analiza e burimeve të krijimit për këtë pasuri

1.9. Për të analizuar burimet e të ardhurave për mundësinë e pagimit të çmimit të pasurisë së paluajtshme apartament, Komisioni iu referua deklarimeve të subjektit, ndër vite, si dhe deklarimit në deklaratën *Vetting*, duke i analizuar ato si vijon:

i) Lidhur me huana në shumën 3.000.000 lekë nga babai i subjektit, z. Sh.R

1.10. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë hua pa afat nga babai i tij, për blerjen e apartamentit të banimit (një nga burimet e të ardhurave) në vlerën prej 3.000.000 lekësh. Gjithashtu, kjo hua dhe qëllimi i marrjes është deklaruar edhe në DVP-në e vitit 2009. Në DVP-të e viteve në vazhdim kjo hua është deklaruar si detyrim i pashlyer prej subjektit. Kjo hua verbale është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting* si hua e pashlyer.

1.11. Sipas deklarimeve të subjektit, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2014, subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave të huadhënësit është nga puna në emigracion, në Greqi, në bujqësi dhe nga biznesi privat “M” i regjistruar si biznes i vogël në Bashkinë Libohovë.

1.12. ILDKPKI-ja, në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara nga neni 33 i ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2017, i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër.

1.13. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot, datë 16.8.2017, konfirmon se nga verifikimi në sistemin tatimor EC@TS, rezultoi se subjekti “Sh.R”, me NIPT *** , me administrator z. Sh.R, nuk ka deklaruar qarkullim dhe fitim në sistemin tatimor EC@TS.

1.14. Me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2017, Bashkia Libohovë informon se shtetasi Sh.R ka qenë i regjistruar me NIPT *** , datë 14.2.2011 dhe ka ushtruar aktivitet në fushën e marangozisë për periudhën 2011– 2014.

1.15. Për sa i takon të ardhurave të siguruara nga biznesi i vogël “M”, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2020, i ka kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

1.16. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i vë në dispozicion Komisionit shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastër, e cila informon, ndër të tjera, se z. Sh.R figuron i regjistruar si person fizik me NIPT *** , me datë regjistrimi 14.2.2011.

1.17. Subjekti figuron me status kërkesë për çregjistrim që prej datës 12.3.2015. Komisioni ka pyetur subjektin në lidhje me dokumentacionin provues ligjor për burimin e krijimit të shumës prej 3.000.000 lekësh nga babai i tij për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 119 m², në vitin 2009.

1.18. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti sqaron se: *“Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait ai me ka deklaruar verbalisht, si dhe ka lëshuar deklaratën noteriale nr. *** , datë 10.1.2020, ku deklaroi se: ‘Këtë shumë parash e kam siguruar nga të ardhurat e fituara në shtetin Grek në periudhën 1991 – 1996, nga të ardhurat e fituara nga periudha 1996 e një vijim, nga biznesi që kisha ‘M’, të cilin e kam pasur të regjistruar në Bashkinë Libohovë, si biznes i vogël dhe ku kam paguar taksat vendore pranë kësaj Bashkie, si dhe nga të ardhurat e fituara së bashku me bashkëshorten time H.R, si të vetëpunësuar në bujqësi, ku kemi kultivuar dhe më pas shitur prodhime të ndryshme bujqësore, në tokën të cilën e kemi përfituar me ligjin nr. 7501 “Për tokën”. Huan verbale pa interes ja kam dhënë djalit pa afat kthimi dhe nuk e kam dokumentuar me akt noterial. Të ardhurat e fituara në shtetin Grek, në periudhën 1991 – 1996, ku kam qenë informal, nuk i kam të dokumentuara, pasi nuk kam qenë i regjistruar. Për të ardhurat e fituara nga biznesi M, kam shlyer detyrimet tatimore vendore pranë Bashkisë Libohovë, ndërsa si i vetëpunësuar në bujqësi, se bashku me bashkëshorten H.R, kemi paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pranë DRSSH-së Gjirokastër, si dhe kemi paguar detyrimet vendore për tokën e përfituar sipas ligjit nr. 7501”.*

1.19. Me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, “Fondi Besa”² informon Komisionin se shtetasi Sh.R ka marrë kredi pranë “Fondit Besa” në datën 9.6.2003, në shumën 500.000 lekë, me afat 24 muaj, me një interes 24% në vit (2% në muaj kundrejt kapitalit të mbetur për të shlyer).

1.20. Nga dokumentacioni në dosje rezulton se kjo kredi është shlyer nga huamarrësi Sh.R sipas kalendarit të shlyerjeve të miratuar nga palët.

1.21. Në deklaratën *Vetting*, në lidhje me këtë hua, nga subjekti në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë është deklaruar se nuk është shlyer asnjë shumë.

²“Fondi Besa” vë në dispozicion praktikën e kredisë së shtetasit Sh.R.

1.22. Sa më sipër nga Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, deklarimet e subjektit dhe faktet e hetimit administrativ, i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, lidhur me sa duket se: subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e krijuara nga emigracioni, nga puna në aktivitetin privat “M”, nga puna në bujqësi për personin tjetër të lidhur, babain e tij, duke mos arritur të dokumentojë burimin e ligjshëm të huas së marrë nga huadhënësi Sh.R.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

1.23. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti shkresat dhe komunikimet e Bashkisë Libohovë, si dhe ka paraqitur në cilësinë e provës lejen higjeno-sanitar të vitit 1997, për ushtrimin e aktivitetit prej tij, lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror i Rrethit Gjirokastrë, leje higjeno-sanitare nr. ***, datë 9.1.1997.

1.24. Gjithashtu, subjekti paraqiti në cilësinë e provës dhe kërkesën (pa datë) lëshuar nga ish-kryetari i Bashkisë Libohovë, z. B.Ç., në të cilën i është kërkuar Korporatës Elektrike Gjirokastrë, dega Libohovë si vijon: “*Qytetari Sh.R, ka ndërtuar zdrukthëtari me leje te rregullt ndërtimi nga Bashkia. Për sa me sipër kërkojmë të transferohet kontrata, pasi ndërtesa e mëparshme nuk ishte në gjendje pune dhe të lidhet me energji elektrike nga kjo korporatë*”, duke referuar se z. B.Ç. ka qenë kryetar i Bashkisë Libohovë, deri në vitin 1998, si një fakt të njohur botërisht.

1.25. Subjekti, në lidhje me huan që babai kishte marrë në vitin 2005, paraqiti si provë vërtetimin nr. *** prot., datë 15.4.2022, lëshuar nga Institucioni Financiar Fondi Besa, Dega Rajonale Gjirokastrë, në të cilin rezultoi se: “*Z. Sh.R, në datën 9.6.2003 ka marrë kredi pranë ‘Fondit Besa’ në shumën 500.000 lekë, me afat 24 muaj, me kontratën³ me nr. ***, datë 3.6.2003 dhe e ka mbyllur kredinë në datën 22.6.2005*”.

1.26. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës të dërguar nga Komisioni, ka shpjeguar se *aktiviteti i ushtruar nga prindërit ka qenë pjesërisht artizanal/ambulant, konkretisht për babain, i cili ka qenë marangoz, pavarësisht se ka qenë i regjistruar si biznes dhe ka pasur një vend ushtrimi të aktivitetit, kryesisht ka prodhuar artikuj druri me porosi, si dhe pjesë për vegla pune, artikuj të ndryshëm druri shtëpiake për kuzhinë, blegtori, si dhe zbukurime të ndryshme në dru, artikuj të cilët në të shumtën e rasteve shiteshin në fshat dhe në fshatrat përreth me porosi dhe/ose në tregjet e komunës. Të dy prindërit janë marrë në mënyrë artizanale/ambulante, me kultivimin të drithërave dhe bimëve medicinale, perimeve etj., për përdorim personal, si dhe për shitje në treg në fshat dhe në fshatrat përreth.*

Për këto lloj aktivitetesh, sipas ligjeve të kohës paguheshin sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si i vetëpunësuar në bujqësi, taksat vendore, si dhe tatimi si biznes i vogël (tatim i thjeshtuar mbi fitimin). Fakti i mosrakordimit ndërmjet organeve tatimore vendore të Bashkisë Libohovë, me organet tatimore qendrore, për regjistrimin e subjekteve që prej fillimit të ushtrimit të aktivitetit, nuk sjell si pasojë përfundimin që veprimtaria të jetë e paligjshme. Kjo pasi në atë kohë, babai ka ushtruar veprimtarinë tregtare, i regjistruar si biznes i vogël pranë Bashkisë Libohovë, si dhe në formën ambulatory kryesisht pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit.

³Bashkëngjitur gjeni në cilësinë e provës: kontratë huaje me garanci hipotekore, datë 3.6.2003, lidhur mes “Fondit Besa” dhe z. Sh.R, e cila përmban dhe kalendarin e shlyerjes e pagimeve të kësteve, si dhe vërtetim bankar për mbylljen e kredisë sipas kalendarit të shlyerjes.

1.27. Trupi gjykues i Komisionit, pasi njoftoi riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Emiljano Ruli, njoftoi subjektin se për sa i përket hetimit shtesë të kryer lidhur me kriterin e pasurisë, lidhur me mundësinë financiare të babait për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit shumën prej 3.000.000 lekësh, në vitin 2009, nuk është arritur të provohet nga hetimi shtesë dhe provat e depozituara nga ana e subjektit të rivlerësimit mundësia financiare e babait të subjektit për dhënien e kësaj huaje.

1.28. Në përgjigje të kësaj barre prove të dërguar rishtazi nga Komisioni, subjekti paraqiti përsëri prova edhe shpjegime lidhur me mundësinë financiare të babait të tij huadhënës, në shumën 3.000.000 lekë në vitin 2009, të cilat u administruan dhe u analizuan nga trupi gjykues.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.29. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancat dëgjimore, arsyeton se:

1.30. Subjektet e rivlerësimit mbartin detyrimin që për secilën pasuri, të deklarojnë burimin e krijimit në momentin e krijimit të tyre, sipas përcaktimeve në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 7 të udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, udhëzimi nr. ***, i ILDKPKI-së).

1.31. Komisioni vlerësoi të analizojë të gjithë burimet e të ardhurave të deklaruara nga subjekti lidhur me huan e marrë nga babai i tij, në vlerën 3.000.000 lekë, në vitin 2009.

Sipas deklaratimeve të subjektit, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në vitin 2014, subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave të huadhënësit është *nga puna në emigracion, në Greqi, në bujqësi dhe nga biznesi privat “M” i regjistruar si biznes i vogël në Bashkinë Libohovë..*

Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit nga puna në emigracion, në Greqi

1.32. Të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për punësimin e personit të lidhur, baba të tij, në emigracion, në Greqi, për sa janë deklaruar si burim për këtë hua, nuk mund të përjashtohen nga analiza mbi ligjshmërinë e krijimit si detyrim kushtetues i palëve në proces. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me asnjë dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave të deklaruara si burim i krijimit të shumës së dhënë hua prej babait të tij.

Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit nga bujqësia

1.33. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se në dokumentet e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, provohet vetëm se prindërit e subjektit kishin përfituar tokë bujqësore, sipas ligjit nr. 7501 “Për tokën”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues: të ardhurat nga aktiviteti bujqësor; si dhe të ardhurat nga mbledhja dhe tregtimi i bimëve medicinale.

1.34. Subjekti si dokument në lidhje me të ardhurat nga puna në bujqësi ka paraqitur vërtetim nr. ***, datë 31.10.2014, të Bashkisë Libohovë, e cila konfirmon se familja e z. Sh.R kultivon bimë mjekësore dhe ka të ardhura në shumën 500.000 lekë/vit. Komisioni vlerësoi se të ardhurat nga bujqësia mbeten vetëm në kuadrin deklarativ, pasi ato nuk u arritën të vërtetoheshin me dokumentacion ligjor provues, në lidhjen e pagimit tatimor që prindërit e subjektit kishin të ardhura nga bujqësia në masën 500.000 lekë/vit, sipas pretendimit të subjektit.

1.35. Referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit këto të ardhura nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti tregtar

1.36. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit, shkresën kthim përgjigje të Bashkisë Libohovë, ndër të tjera, thuhet se: “... *aktiviteti i biznesit ka filluar në vitin 2001... janë paguar të gjitha taksat dhe Sh.R nuk ka asnjë detyrim... taksat janë paguar rregullisht...*”.

1.37. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, arsyeton si vijon.

1.38. Subjekti ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit dhe në seancë dëgjimore se babai ka regjistruar biznesin në vitin 2001 dhe është regjistruar si tatim pagues pranë Bashkisë Libohovë. Komisioni, referuar legjislacionit tatimor të kohës, vërejtë se sipas ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ndryshuar, me ligjin nr. 8715 datë 15.12.2000, tatimi për biznesin e vogël për personat fizikë me qarkullim nga 0 - 2.000.000 lekë/vit është kuotë fikse vjetore dhe organi kompetent për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e detyrimeve është Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë. Rezulton se babai i subjektit nuk është regjistruar në vitin 2001, vit kur pretendohet se ka filluar aktivitetin, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimor Gjirokastrë.

1.39. Komisioni analizoi dhe vlerësoi dhe dokumentet shoqërues që i bashkëlidhesh shkresës përcjellëse, ku evidentohet se taksat janë paguar vetëm për vitet 2003, 2004 dhe 2006. Referuar ligjit 8978 datë 12.12.2002, këto mandate provuan vetëm pagimin e taksës vendore për vitet 2003, 2004, dhe 2006 si më poshtë vijon:

1. Flete njoftimi taksat 2003 + mandate arketimi
2. Akt detyrimi taksat 2004 + mandate arketimi
3. Akt detyrimi taksat 2006+ mandate arketimi
4. Akt detyrimi taksat 2007
5. Akt detyrimi taksat 2008 (pa paguar 2007, 2008)
6. Akt detyrimi taksat 2009 (pa paguar 2007, 2008, 2009)
7. Akt detyrimi taksat 2010 (pa paguar 2007, 2008, 2009, 2010)
8. Akt detyrimi taksat 2011
9. Akt detyrimi taksat 2012 (pa paguar 2011, 2012)
10. Akt detyrimi taksat 2013 (pa paguar 2011, 2012, 2013)
11. Akt detyrimi taksat 2014 (pa paguar 2011, 2012, 2013, 2014)

1.40. Me ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, personat fizikë që nuk janë subjekt i TVSH-së, paguajnë kuotë fikse, sipas llojit të aktivitetit, për qarkullim 0-2.000.000 lekë/vit dhe organi kompetent për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e detyrimeve është Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

1.40.1 Sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “ Për sistemin e taksave vendore”, neni 11 përcakton nivelin tregues i taksës , për çdo kategori biznesi, në varësi të qarkullimit vjetor. Për bizneset, duke filluar nga vlera minimale deri në 2.000.000 lekë, detyrimi fiskal tregues është fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi. Në referim të këtij ligji, organi kompetent për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e detyrimeve janë organet e pushtetit vendor (Bashkia Libohovë)

1.40.2. Komisioni arsyeton se referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, mandatet për vitet 2003, 2004 dhe 2006 provuan vetëm pagimin e taksës vendore për keto vite. Trupi gjykues vlerëson se lidhur me të ardhurat para vitit 2007 subjekti i rivlerësimit duhet të paraqiste dokumentacion ligjor provues lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër.

1.40.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se *në zbatim të këtyre normave juridike, rezulton se rregjistrimi, pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, do duhej të ishte kryer nga administrata tatimore qendrore (Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokaster), mbi informacionin që Bashkia Libohovë duhet ti kishte dërguar çdo 30 ditë, dhe kjo gjë do të ishte e barazvlefshme me rregjistrimin e kryer nga vetë individi, si dhe barazohet per efekt te nenit 12 pika 4 te Ligjit nr. 9632 date 30.10.2006 me rregjistrimin qe i ka bërë Bashkia Libohovë, në vitin 2001.Në rastin konkret mosrregjistrimi i babait në vitin 2001 pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokaster, por rregjistrimi i tij, vetëm pranë Bashkisë Libohovë, duhet të vlerësohet nga institucioni sipas nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk duhet të sjellë pasoja negative në drejtim të barrës së provës që më ngarkon ligji, për të vërtetuar burimet e ligjshme të të ardhurave, trupi gjykues vlerëson se që subjekti të jetë në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon dhe ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, gjë që nuk u arrit të provohej nga subjekti i rivlerësimit.*

1.41. Me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, u përcaktua se organi kompetent për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e detyrimeve do të ishte organi vendor Drejtoria Rajonale Tatimore Vendore. Pas ndryshimeve ligjore si me siper në ligjin e taksave, i cili përcaktonte se bizneset duhet të deklaroheshin dhe të paguanin taksat në nivelin lokal të ardhurat nga 2007-2009, per babain e subjektit ishin përkatësisht 1.000.000/ve vit, siç referonte vërtetimi nr. ***, i Bashkisë Libohovë, Komisioni analizoi dhe dokumentet shoqërues (i) akt detyrimi taksat 2007; (ii) akt detyrimi taksat 2008 (pa paguar 2007, 2008); (iii) akt detyrimi taksat 2009 (pa paguar 2007, 2008, 2009); (iv) akt detyrimi taksat 2010 (pa paguar 2007, 2008, 2009, 2010); Këto prova nuk janë të shoqëruara më mandat pagesat në vitet përkatëse që të provojnë pagesën e detyrimeve.

1.42 Në lidhje me pretendimet e subjektit se babai ka paguar detyrimet se bashku me gjobat për shkak të vonesës, trupi gjykues nuk evidentoi ndonje provë të shkruar në formë mandati apo dokument tjetër të kohës që të provonte që detyrimet për vitin 2007, 2008, 2009 ishin paguar. Faktet e referuara në shkresën me nr. *** prot datë 21.04.2022 të Bashkisë Libohovë e cila citon se: “*Detyrimet tatimore dhe taksat vendore të vendosura për çdo vit kalëndarik nga Këshilli Bashkiak, janë paguar të gjitha në bazë të mandat arketimeve dhe faturave të bankës, dhe si rrjedhojë nuk rezultojnë të jetë debitor ndaj Bashkisë Libohovë*”, nuk provohen me mandat pagesa apo fatura bankare e megjithatë, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin e të dhënave që ka administruar nga biznesi i babait, vlerësoi të marrë në konsideratë shkresën e mësipërme që evidenton faktin se babai i subjektit nuk është debitor, dhe të vlerësojë si të ardhura të ligjshme të ardhurat nga vitet 2007-2009, të cilat në total shkojnë 3.000.000 lekë.

1.43. Në lidhje me pretendimet e subjektit se babait ka ushtruar veprimtarinë tregtare, i regjistruar si biznes i vogël pranë Bashkisë Libohovë dhe në formën ambulatorie kryesisht pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit. Komisioni verën se ky pretendim bie ndesh me provat e paraqitura nga subjekti në seancën degjimore, të lëshuara nga Bashkia Libohovë, .:i) Fletë Njoftimi e datës 13.05.2003 për z. Sh.R me objekt aktiviteti “Përpunim druri”, me veprimtari “ në Njësi”, vendodhja “****” shoqëruar me plan vendosje të njësisë më sipërfaqe 59 m2. ii) Akt Detyrim për vitin 2006 z. Sh.R me objekt aktiviteti “Përpunim druri”, veprimtaria “ në Njësi”, vendodhja “ ****”; iv) Akt Detyrim për vitin 2007, veprimtaria “ në Njësi”; ”, vendodhja “ ****”; v)Akt Detyrim për vitin 2008 veprimtaria “ në Njësi”, vendodhja “ ****”; vi) Akt Detyrim për vitin 2009, veprimtaria “në Njësi” etj;

1.44. Të gjitha këto akte administrative të lëshuara nga Bashkia Libohovë kanë të përcaktuar kryerjen e veprimtarisë “në njësi” dhe jo ambulant siç pretendon subjekti. Këto prova së bashku me shkresën e Kryetarit të Bashkisë Libohovë⁴ i cili i kërkon Korporatës Elektrike Gjirokastër të lidhë energjinë qytetarit Sh.R i cili ka ndërtuar zdrukhtari me leje të rregullt ndërtimi dhe Lejen Higjeno sanitare për Objektin datë 09.08.1997 përforcojnë vendimin e Komisionit se ky aktivitet nuk ushtrohej në menyre ambulante siç e pretendon subjekti.

1.45. Nëse në funksion të një analize garantuese dhe shteruese të ardhurat nga zdrukthëtaria për periudhën 2007-2009 do të konsideroheshin të ardhurat në shumën 3.000.000 lekë, përkatësisht 1.000.000/ne vit, siç referonte vërtetimi nr. ***, i Bashkisë Libohovë, dhe nese prej tyre do të zbriteshin shpenzimet jetike për të njëjtën periudhë, referuar numrit të anëtarëve të familjes së subjektit (5 anëtarë)⁵, pa llogaritur asnjë shpenzim tjetër, mundësia e kursimit të babait do te ishte e pamjaftueshme për të justifikuar dhënien hua të shumës prej 3.000.000 lekë, subjektit të rivleresimit në vitin 2009.

1.46. Nga vlerësimi i situatës faktike financiare të prindërve të subjektit, trupi gjykues vlerëson se nga prindërit e tij, nuk provohet se ata kanë pasur likuiditete gjendje për dhënien e huasë subjektit.

1.47. Ky konkluzion i trupit gjykues bazohet edhe në sa ka rezultuar nga hetimi administrative lidhur me mundësitë financiare të babait të subjektit, e cila referuar huamarrjes së babait të subjektit në “Fondin Besa” dhe përqindjes së lartë të normës së kreditimit të përdorur për këtë huadhënie, nuk tregon një situatë financiare të tillë të babait të subjektit, që të mundësonte krijimin e likuiditeteve *cash* nga babai i subjektit, gjate viteve 2003-2005.

1.48. Përveç sa më sipër trupi gjykues mban në konsideratë dhe:

- mungesa e të dhënave në sistemin bankar, lidhur me mundësitë e kursimit të prindërve të subjektit;
- mungesa e provueshmërisë, lidhur me mënyrën e përfitimit/transaksionin e kryer, i cili nuk rezulton i provuar në ndonjë formë;
- mungesa e provueshmërisë, lidhur me mënyrën e shlyerjes/transaksionin së kësaj huaje, e cila nuk rezulton e shlyer nga subjekti për një periudhë 10-vjeçare;

1.49. Keto fakte nuk krijojnë bindjen mbi mundësinë financiare të babait për dhënien e huasë së pretenduar.

1.50. Mungesa e provueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e tyre nga prindërit e subjektit, tregojnë sipas një vlerësimi tërësor të të gjitha hallkave të zinxhirit të burimeve të

⁴ Sipas subjektit kryetari B.C ka qene ne detyre nderi në vitin 1998.

⁵ Referuar certifikates familjare, familja e subjektit perbehet nga pese antare, tre femijet dhe prinderit.

pretenduara, se pavarësisht përpjekjeve, subjekti dështoi të provojë se burimi i huas në vlerën 3.000.000 lekë nga prindërit e tij për pagimin e apartamentit kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84.2016.

1.51. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e huas së dhënë nga prindërit në shumën 3.000.000 lekë, në vitin 2009, ndaj dhe huaja e dhënë nga prindërit e subjektit në shumën 3.000.000 lekë, në vitin 2009 nuk mund të përfshihet në analizën financiare, lidhur me pagimin e pasurisë së paluajtshme nga ana e subjektit të rivlerësimit, në vitin 2009.

ii) Hua e marrë nga shtetasi A.Z, në shumën 4.000.000 lekë

1.52. Në DVP-në e vitit 2009, në ndryshimet e interesave, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar edhe kontratë huaje në shumën 4.000.000 lekë, nga shtetasi A.Z, me qëllim blerje apartamenti.

1.53. Në bazë të kontratës së huas, datë 7.12.2009, subjekti i rivlerësimit ka marrë nga huadhënësi A.Z shumën 4.000.000 lekë, me qëllim blerje apartament banimi pranë shoqërisë së ndërtimit “**** (***)” sh.p.k. Kjo kontratë huaje është lidhur pa interes dhe me afat shlyerje deri në momentin e marrjes së kredisë nga huamarrësi pranë BKT-së ose çdo bankë tjetër. Huaja i është dhënë huamarrësit Emiljano Ruli nga huadhënësi A.Z, para lidhjes së kontratës me firmën e ndërtimit.

1.54. Lidhur me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua, nga vlerësimi i akteve të administruara, rezultojnë rrethanat si vijon: (i) në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur kontratën e huas nr. ***, datë 7.12.2009, me huadhënësi shtetasin A.Z, si dhe kopje e ekstraktit të shoqërisë “****” sh.p.k., ku z. A.Z është ortak me 51% të kuotave dhe administrator i kësaj shoqërie; (ii) në procesverbalin⁶ e mbajtur në ILDKPKI në datën 7.11.2014, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetjes nr. 5, në lidhje me burimin e të ardhurave të shtetasit A.Z, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... shtetasi A.Z është përfaqësues ligjor dhe ortak me 51% të aksioneve të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., për të cilën ju vë në dispozicion ekstraktin e QKR-së...lidhja ime me të është shoqërore, miqësore që nga viti 1999. Deklaroj se nuk kam pasur çështje gjyqësore me A.Z apo familjarët e tij”.

1.55. Referuar informacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 28.7.2017 dhe shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së⁷, konfirmohen: të regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë shoqëria “****” sh.p.k., NIPT ***, me objekt punime ndërtimi regjistruar në datën 11.2.2009 kaluar me status pasiv më 18.12.2014; si dhe shoqëria “****” sh.p.k., regjistruar me NIPT ***, e cila nuk ka shpërndarë dividend për periudhën 1998 – 2009.

1.56. Në pyetësorin nr.1, subjekti, në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit A.Z, është shprehur, ndër të tjera, se: “...në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit A.Z, ai më ka deklaruar verbalisht në kohën e dhënies, se ishte ortak dhe administrator i shoqërisë ‘****’ sh.p.k., e cila kishte likuiditet në gjendje cash jashtë sistemit bankar, të përfutur nga shitjet apo kontratat e sipërmarrjeve që lidhte me blerës të ndryshëm dhe që i përdorte për shpenzimet koherente. Po kështu më ka deklaruar se kishte disa llogari bankare në banka të ndryshme dhe për shkak të tërheqjeve që kishte bërë ndër vite, kishte likuiditet cash në gjendje...”.

⁶Dokumentacion pjesë e shkresës kthim përgjigje nr.*** prot., datë 11.2.2020, nga ILDKPKI-ja.

⁷Faqe ***, e dosjes së ILDKPKI-së.

1.57. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka depozituar: (i) ekstrakt i regjistrimit tregtar për shoqërinë “****” sh.p.k. lëshuar në datën 27.7.2009; (ii) statement i llogarisë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. në euro, për periudhën 1.9.2009-31.12.2009, në “Intesa Sanpaolo Bank”, sipas së cilës rezulton se shtetasi A.Z ka tërhequr *cash* në datën 27.8.2009, shumën prej 42.000 euro.

1.58. Në vlerësim të faktit se subjekti i rivlerësimit edhe shtetasi A.Z, si person i lidhur i deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë konfirmuar këtë marrëdhënie dhe referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, likuiditetet dhëna hua.

1.59. Detyrimi ligjor dhe kushtetues gjatë procesit të rivlerësimit është justifikimi dhe argumentimi me dokumente shoqëruese i ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie, likuiditetet dhëna hua, referuar kontratës së huas, datë 7.12.2009, përdorur si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit.

1.60. Me revokimin e kontratës së huas nr. ***, datë 26.4.2010, nga palët huadhënëse A.Z dhe huamarrës Emiljano Ruli, është revokuar kontrata e huas e datës 7.12.2009, për blerje apartament banimi me vlerë huaje 4.000.000 lekë.

1.61. Në DVP-në e vitit 2010, në formularin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “..(i) *revokim kontrate huaje nr. ***, datë 26.4.2010, për revokimin e kontratës së huas nr. ***, datë 7.12.2009, me huadhënëse A.Z dhe huamarrës Emiljano Ruli, për blerje apartament banimi, vlera e huas së revokuar 4.000.000 lekë shlyer me kontratë kredie me nr. ***, datë 27.2.2010 dhe me kontratë huaje nr. ***, datë 11.1.2010; (ii) kontratë kredie bankare me hipoteke, nr. ***, datë 27.2.2010. Kredidhënëse ‘Raiffeisen Bank’. Shuma e kredisë 2.000.000 lekë, me qëllim shlyerjen e huas nr. ***, datë 7.12.2009, me huadhënëse A.Z për blerje apartamenti me afat 180 muaj, interesi 12.20% me këst mujor 24.274 lekë; (iii) kontratë huaje me nr. ***, datë 11.1.2010, huadhënëse H.K, me vlerë 2.000.000 lekë, me afat 6-vjeçar, me qëllim shlyerjen e huas së marrë huadhënësit A.Z..”.*

1.62. Me kontratën e huas nr. ***, datë 11.1.2010, subjekti ka marrë hua nga huadhënësi H.K, huan në shumën prej 2.000.000 lekësh, me qëllim shlyerjen e pjeshme të huas së marrë nga z. A.Z, me kontratën e datës 7.12.2009, me qëllim blerje apartamenti banimi pranë shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo kontratë huaje është lidhur për një afat 6-vjeçar nga momenti i nënshkrimit pa interes, për shkak të marrëdhënieve familjare midis palëve⁸.

1.63. Huaja e marrë huadhënësit H.K i është kthyer në shumën 2.000.000 lekë, nga znj. L.G, nëna e bashkëshortes së subjektit me të ardhurat e përfituara nga kjo e fundit prej kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 5.01.2018.

1.64. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja e subjektit në cilësinë e kredimarrësit dhe subjekti bashkëkredimarrëse kanë marrë nga “Raiffeisen Bank” një kredi me afat 180 muaj në shumën 2.000.000 lekë kredi, e cila në datën 11.3.2010 është disbursuar në llogarinë e pagës në emër të shtetases V.R dhe më 19.3.2010 është tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit shuma prej 1.900.000 lekësh.

⁸Në deklaratën *Vetting* subjekti ka bashkëlidhur ndër të tjera kontratën e huas me nr. ***, datë 11.1.2010, kopje të ekstraktit të personit fizik H.K me nr. *** me veprimtari projektues Arkitekt me datë të regjistrimit 28.4.1993, data e ekstraktit më 28.10.2011, si dhe një deklaratë parashikuese të qarkullimit vjetor të personit fizik H.K, i cili parashikon të ardhura vjetore në shumën 3.000.000 lekë.

1.65. Në pyetësorin standard, në lidhje me këtë kredi bankare, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: *“Së bashku me bashkëshorten kemi përfituar kredi sipas kontratës për kredi bankare dhe hipotekore nr. ***, datë 27.2.2010, me kredidhënës ‘Raiffeisen Bank’, në vlerën 2.000.000 lekë. Këtë kredi konsumatore e kam përdorur për shlyerjen e huas së marrë sipas kontratës së huas me nr. ***, datë 7.12.2009, nga huadhënës A.Z, për blerje apartament banimi”*.

1.66. Kredia bankare është shlyer në datën 26.11.2011, datë kur bashkëshortja e subjektit V.R, ka marrë hua nga huadhënësi K.D (daja i saj) shumën 1.980.000 lekë, pa afat, nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e subjektit farmaci “****” sh.p.k.

1.67. Në DPV-në e vitit 2011, në formularin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: kontratë huaje verbale, ndërmjet huadhënës K.D(daja i bashkëshortes) ortak i vetëm dhe administrator i subjektit farmaci “****” sh.p.k. Huamarrës V.R në vlerën 1.980.000 lekë, me qëllim shlyerjen e kredisë me kontratë kredie bankare dhe hipotekë me nr. ***, datë 27.2.2010, me kredidhënës “Raiffeisen Bank”, në vlerën 2.000.000 lekë, pa afat, nëpërmjet transfertës nga llogaria bankare e subjektit farmaci “****” sh.p.k.

1.68. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank” në datën 26.9.2011 është transferuar në llogari të personit të lidhur (bashkëshorte e subjektit), nga “****” sh.p.k., shuma 1.980.000 lekë, me përshkrimin “dhënie huaje” dhe më 28.9.2011 është mbyllur kredia duke paguar principal në shumën 1.902.160 lekë, interes 1.104 lekë dhe komision në shumën 57.065 lekë.

1.69. Në lidhje me këtë hua, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit lidhur me sa duket se: *“Subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e krijuara nga shtetasi A.Z, pasi shoqëria e këtij të fundit nuk ka shpërndarë dividend për periudhën nga viti 1998 deri në vitin 2009, duke mos arritur të dokumentojë burimin e ligjshëm të huas marrë nga huadhënësi A.Z, përdorur si burim për apartamentin me sip. 119.3 m², në Tiranë, për shlyerjen e shumës prej 8.631.500 lekësh, në datën 12.11.2009”*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

1.70. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se me vendimin⁹ ***, datë 17.7.2009, të Asamblesë së Zakonshme të ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k., pika ***, është vendosur: *“Nga fitimi ushtrimor i vitit 2008, në vlerën 18.877.510 lekë (shihni pasqyrat financiare të vitit 2008), të bëhet shpërndarja e këtij fitimi në vlerën 13.238.948 lekë, si dhe pjesa e mbetur e fitimit të vitit ushtrimor 2008 në vlerën 5.638.562, së bashku me fitim e mbartur deri në vitin 2007, 21.240.515 lekë të mos shpërndahet, por do të përdoret për zhvillimin në vazhdimësi të aktivitetit. Shoqëria ka pasur dy ortak, ku z. A.Z zotëronte 51% të kapitalit.*

1.71. Ky vendim është publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit¹⁰ në datën 27.7.2009, numri i çështjes: *** (sipas ekstraktit historik për të dhënat e subjektit), si dhe është deklaruar rregullisht pranë DRT-së Tiranë. Sipas përqindjes së kapitalit që zotëron ortakun A.Z, ka përfituar shumën prej 6.751.863 lekësh, nga dividendi i shpërndarë.

⁹Bashkëngjitur gjeni në cilësinë e provës: vendimin nr***, datë 17.7.2009, të Asamblesë së Zakonshme të ortakëve të shoqërisë “****”sh.p.k.

¹⁰Bashkëngjitur gjeni në cilësinë e provës: ekstraktin historik të shoqërisë të nxjerrë nga faqja zyrtare e QKB-së.

1.72. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2022, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Sektori i Kontabilitetit të të Ardhurave¹¹, me lëndë “Konfirmim pagese tatim në burim”, drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, rezulton se: “Shoqëria ‘****’ sh.p.k., me NIPT ***, ka paguar tatim në burim (tatim mbi dividendin viti 2008), në datën 7.7.2009, pranë ‘Tirana Bank’, në shumën 1.323.894 lekë” (për më tepër shihni pasqyra e fluksit monetar-metoda direkte viti 2009), bashkëngjitur si provë.

1.73. Komisioni, pas riçeljes së hetimit administrativ lidhur me kriterin e pasurisë në kërkimin e bërë në “Tirana Bank”, konfirmoi pagimin e shumës së referuar nga organi tatimor lidhur me shpërndarjen e dividendit mbi këtë shoqëri.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.74. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancën dëgjimore të datës, arsyeton se:

1.75. Rezulton e provuar që shoqëria bazuar në vendimin e ortakëve për shpërndarjen e dividendit në shumën 13.238.948 lekë ka paguar tatim në burim 1.323.894 lekë ose 10% tatim të dividendit, sipas parashikimeve ligjore të asaj kohe.

1.76. Nga analizimi i pasqyrave financiare të vitit 2009, rezulton se është shpërndarë dividend në shumën 13.238.948 lekë dhe ortakët e shoqërisë e kanë tërhequr të gjitha brenda vitit 2009. Në pasqyrat financiare, në pozicionin “Huat dhe parapagimet”, zëri “Dividendë për t’u paguar” është (0) zero, duke vërtetuar faktin se dividendi i shpërndarë është tërhequr nga ortakët brenda vitit 2009.

1.77. Fitimi i shoqërisë për vitin 2008 në shumën 18.877.510 lekë është destinuar duke u shpërndarë shuma prej 13.238.949 lekësh ortakëve dhe diferenca prej 5.638.562 lekësh ka kaluar në zërin “Fitime të pashpërndara”. Në përputhje me nenin 8 “Të ardhurat e tatueshme” dhe nenin 33 “Mbajtja e tatimit në burim”, të ligjit nr. 8438, i ndryshuar, shuma e të hollave të tërhequra nga shtetasi A.Z pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 27.8.2009 janë marrë si dividend nga fitimi i vitit 2008 dhe për to është paguar tatimi në burim për shumën e fitimit të shpërndarë.

1.78. Fitimi i shpërndarë është tërhequr prej tij personalisht, sipas statement i llogarisë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. me nr. *** dhe nr. ***, në euro, pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, sipas së cilës rezulton se shtetasi A.Z, ka tërhequr *cash* në datën 27.8.2009, shumën prej 42.000 euro.

1.79. Referuar lëvizjeve bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, rezulton se në datën 27.8.2009 është tërhequr *cash* shuma 42.000 Euro, gjendja e mbetur në llogari në emër të shoqërisë “****”, sh.p.k. deri në fund të vitit 2009, ka mbetur e paprekur 20.455 euro.

1.80. Pas rihapjes së hetimeve lidhur me kriterin e pasurisë dhe administrimit të:

¹¹Bashkëngjitur gjeni në cilësinë e provës: shkresës nr. *** prot., datë 28.4.2022, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Sektori i Kontabilitetit të të Ardhurave.

- vendimi i asamblesë së aksionerëve për shpërndarjen e fitimit në vitin 2009;
- një rikonfirmim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve se taksat mbi dividendët janë paguar në vitin 2009;
- llogarive bankare të shtetasit A.Z në sistemin bankar, mbi gjendjen e te ardhurave dhe shpenzimeve të këtij shtetasi në vitin e dhënies së huas dhe pagimin e dividendit nga ana e shoqërisë.

1.81. Trupi gjykues i Komisionit ka arritur në konkluzionin se shtetasi A.Z kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vitin 2009 për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumë 4.000.000 lekë, në vitin 2009 dhe, për këtë arsye, pas riçeljes së hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Emiljano Ruli, njoftoi subjektin se lidhur me huadhënien e z. A.Z është provuar nga hetimi administrativ shtesë dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit se ai ka pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhënë shumë 4.000.000 lekë, hua në vitin 2009 subjektit të rivlerësimit.

iii) Lidhur me tërheqje nga llogaria e pagës së bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 800.000 lekë dhe tërheqje nga llogaria depozitë në emër të subjektit në vlerën 700.000 lekë

1.82. Bazuar në dokumentacionin nga “Raiffeisen Bank”¹², të administruar nga Komisioni rezulton se në datën 23.12.2009, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr *cash* nga llogaria e saj e pagës në këtë bankë shumë prej 700.000 lekësh. Gjithashtu, subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij depozitë shumë prej 714.900 lekësh, më 28.12.2009. Referuar kontratës së porosisë të datës 12.11. 2009, kësti i parë i çmimit të apartamentit është parapaguar para datës 12.11.2009.

1.83. Në pyetësorin standard, subjekti, në lidhje me këtë burim, shpjegon se: *“Shuma 700.000 lekë është tërhequr nga llogaria e pagës së bashkëshortes V.R në llogarinë pranë ‘Raiffeisen Bank’, shuma prej 100.000 lekësh dhe shuma prej 116.600 lekësh, janë tërhequr gjatë vitit 2009 deri në momentin e blerjes nga llogaria e pagës së bashkëshortes, nga tërheqjet që kam bërë nga llogaria bankare e pagës sime, si dhe një pjesë na i ka dhënë vjehrra L.G”*.

1.84. Nga hetimi rezultoi se tërheqjet nga llogaria e subjektit dhe e bashkëshortes së tij janë bërë përkatësisht në datat 28.12.2009 dhe 23.12.2009, pra, pas lidhjes së kontratës së porosisë me shoqërinë “***” sh.p.k. Në lidhje me këtë mospërputhje është pyetur subjekti, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ndër të tjera, shpjegon se: *“Me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. kemi rënë dakord verbalisht që shumë prej 1.631.500 lekësh, t’ia paguaja pasi të tërhiqja paratë nga llogaria bankare pranë ‘Raiffeisen Bank’, si dhe nga llogaria e pagës së bashkëshortes V.R kjo pasi depozita me afat që kisha në bank, nuk mund të tërhiqej pa u maturuar. Gjithashtu, kemi rënë dakord verbalisht që në kontratën e porosisë do të shënohej ‘blerësi ka parapaguar me këste vlerën prej 8,631,500 lekësh përpara nënshkrimit të kontratës’, me qëllim evitimin e bërjes së një kontrate tjetër.*

Shuma prej 1.631.500 lekësh i është paguar shoqërisë rreth datave 29-31.12.2009. Burimi i këtyre të ardhurave ka qenë: (i) shuma 714.900 lekë, e tërhequr nga llogaria ime në datën 28.12.2009; (ii) shuma prej 700.000 lekësh tërhequr nga llogaria e pagës së bashkëshortes V.R; (iii) shuma prej 100.000 lekësh dhe shuma prej 116.600 lekësh janë tërhequr gradualisht me vlera të vogla, gjatë vitit 2009 deri në momentin e blerjes, nga llogaria e pagës së bashkëshortes, nga tërheqjet që kam bërë nga llogaria bankare e pagës sime, si dhe një pjesë na i ka dhënë vjehrra L.G”.

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

1.85. Bazuar në rrethanat dhe faktet e çështjes, tërheqjet e kryera nga subjekti në llogarinë e tij në shumën prej 714.900 lekësh në datën 28.12.2009 dhe tërheqjet nga llogaria e personit të lidhur, bashkëshortes së tij në shumën prej 700.000 lekë në datën 23.12.2009, për efekt të analizës financiare, nuk do të llogariten në pagesën e kështit të parë, pasi janë kryer pas lidhjes së kontratës së porosisë nr. *** prot., datë 12.11.2009. me shoqërinë “****” sh.p.k., ku palët kanë konfirmuar se blerësi ka parapaguar vlerën prej 8.631.500 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

1.86. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“Në lidhje me burimin, tërheqjet nga llogaritë bankare në emër të Emiljano Ruli dhe bashkëshortes në ‘Raiffeisen Bank’ kemi rënë dakord me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. kemi rënë dakord verbalisht që shumën prej 1.631.500 lekësh t’ia paguaja pasi të tërhiqja paratë nga llogaria bankare (depozitë me afat) pranë ‘Raiffeisen Bank’, si dhe nga llogaria e pagës së bashkëshortes V.R(***), kjo pasi depozita me afat që kisha në bank, nuk mund të tërhiqej pa u maturuar. Tërheqja e këtyre shumave nga Banka dhe qëllimi i tërheqjes së tyre për blerje apartamenti, është deklaruar dhe pasqyruar rregullisht edhe në DVP-në 2009, si dhe në deklaratën Vetting. Në kontratën porositje për blerje apartamenti nr. *** prot., datë 12.11.2009, me shoqërinë ‘***’ nuk janë përshkruar kështet dhe datat përkatëse të likuidimit të tyre, që do të shërbenin si një burim i dytë prove, për të vërtetuar faktin nëse pagesa prej 8,631,500 lekësh është paguar përpara datës së nënshkrimit të kontratës. Në kushtet kur në kontratë nuk janë përshkruar mandat arkëtimet e shoqërisë, kur nga ana tjetër shoqëria deklaroi se kontrata është nënshkruar në mirëbesim dhe pagesa efektive është bërë në fund të vitit 2009, nuk mund të merret apriori se këto dy shuma të tërhequra nuk kanë shërbyer si burim për të vetmin fakt se data e tërheqjes është më shumë se një muaj mbrapa nga data e nënshkrimit të kontratës”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.87. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.88. Në nenin 676 të Kodit Civil, parashikohet shprehimisht se kontrata quhet e lidhur, kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellët vullnetin e tyre duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Pra, palët kur lidhin kontratën, duhet të merren vesh¹³, për kushtet që duhet të përmbahen në kontratë. Përcaktimin e kushteve thelbësore të kontratës e bën doktrina, e cila përcakton si kusht thelbësor, objektin, çmimin dhe afatin e kontratës.

1.89. Palët kanë rënë dakord për çmimin e sendit dhe mënyrën e pagesës, që sipas kontratës së porosisë, datë 12.11.2009, kësti i parë ishte parapaguar para nënshkrimit të kontratës. Dispozitat e kontratës që parashikojnë kushtet thelbësore të kontratës janë imperative, urdhëruese, kanë forcën e ligjit dhe duhet të respektohen nga palët.

¹³Kontrata krijon detyrime në pajtim me përmbajtjen e asaj se çfarë është parashikuar në të.

1.90. Në prapësimet e tij, subjekti shprehet se kishin rënë dakord gojarisht që pagesa e njërit prej kësteve dhe, konkretisht, tërheqet nga numri i llogarive të bashkëshorteve të bëhej në fund të vitit për shkak të maturimit të llogarisë së tij.

1.91. Kjo dakordësi, në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit të apartamentit, nuk është pasqyruar në asnjë nga dispozitat e kontratës dhe ku palët kanë shprehur vullnetin e tyre të pavesuar në lidhje me kushtet thelbësore të kontratës.

1.92. Komisioni, në vlerësim të dokumentacionit provues të “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja e subjektit dhe subjekti kanë tërhequr nga llogaritë në datat 23.12.2009 dhe 28.12.2009, që korrespondon me një kohë të mëvonshme nga pagesa e këstit të parapaguar në shumën 8.631.500 lekë dhe kjo shumë ka shërbyer për pagesën e këstit të fundit të çmimit të blerjes në shumën prej 368.500 lekësh, që sipas kontratës së porosisë është data 30.12.2009.

Lidhur me pagesën e këstit të fundit të kësaj pasurie në vlerën 368.500 lekë

1.93. Palët kanë rënë dakord për çmimin e sendit dhe mënyrën e pagesës që sipas kontratës së porosisë datë 12.11.2009, kësti i fundit do të paguhej deri në dhjetor të vitit 2009. Dispozitat e kontratës që parashikojnë kushtet thelbësore të kontratës janë imperative, urdhëruese, kanë forcën e ligjit dhe duhet të respektohen nga palët.

1.94. Subjekti në DPV-në e vitit 2009 nuk ka deklaruar në formularin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizike, detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

1.95. Lidhur me pagesën e këstit të dytë prej 368.500 lekësh dhe kohën e pagimit të tij, subjekti ka shpjeguar se: “...shuma e këstit prej 368.500 lekësh, nuk është përfshirë në DVP-në e vitit 2009 në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, pasi nuk përcaktohej nga ligji i kohës si kredi, huamarrje, detyrim për studime. Kjo shumë është paguar gradualisht, ndër vite, me këste të vogla të cilat ligji i kohës nuk i përcaktonte si shpenzime të deklarueshme dhe as kishte përcaktuar vlerën minimale të tyre. Burimi i të ardhurave i përdorur për këtë shpenzim kanë qenë tërheqje periodike, ndër vite, nga llogaria bankare e pagesës sime dhe e bashkëshortes...”.

1.96. Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore 2009 të subjektit vlerën e provës, në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, duke e çmuar me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli,

1.97. Në komunikimin e vitit 2022, midis Komisionit dhe shoqërisë së ndërtimit, deklarohet se kontrata e shitjes është raportuar pranë autoriteteve më 20.11.2020. Në kontratën e shitjes parashikohet se: “Neni 5: Shitësi deklaron se blerësi ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes së pasurisë së paluajtshme në shumën 9.000.000 lekë, sipas kontratës së sipërmarrjes për blerjen e apartamentit me nr. *** prot., datë 12.11.2009. Shuma është marrë plotësisht nga shitësi”. Kontrata e shitjes e vitit 2020 i referohet kontratës së sipërmarrjes së vitit 2009.

1.98. Në kontratën e sipërmarrjes, neni 3 parashikohet se para nënshkrimit të kontratës janë paguar 8.631.500 lekë dhe kësti i katërt dhe i fundit prej 368.500 lekësh do të paguhet brenda datës 30.12.2009.

1.99. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Pjesa e mbetur do të paguhet pasi të jetë finalizuar dhe regjistruar kontrata e shitjes (në bashkëpronësi me bashkëshorten time)”.

1.100. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit sqaron se: “...kësti prej 368 500 lekësh nuk është përfshirë në DPV 2009, në zërin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, sepse nuk është konsideruar si hua, borxh apo detyrim për studime sipas ligjit në fuqi të asaj kohe. Kjo shumë është paguar gradualisht, ndër vite, me këste të vogla që nuk konsideroheshin si shpenzime të deklarueshme nga ligji në fuqi në atë kohë dhe as nuk ishte përcaktuar/specifikuar shuma minimale e tyre. Burimi i të ardhurave të përdorura për këtë shpenzim përbënte tërheqjet periodike ndër vite nga llogaritë bankare të pagave të mia dhe të bashkëshortes sime...”.

1.101. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues vlerëson se për sa kontrata e shitjes i referohet kontratës së sipërmarrjes dhe kontrata e sipërmarrjes parashikon se kësti i fundit duhej të paguhej brenda datës 30.12.2009. Duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që subjekti në DPV-në e vitit 2009 nuk ka deklaruar në formularin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., Komisioni ka vlerësuar se për efekt të analizës financiare shuma prej 368.500 lekësh do të llogaritet e shlyer në periudhën 13.11.2009-31.12.2009.

1.102. Bazuar në dokumentacionin nga “Raiffeisen Bank”¹⁴, të administruar nga Komisioni rezulton se në datën 23.12.2009, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr *cash* nga llogaria e saj e pagës në këtë bankë shumë prej 700.000 lekësh. Gjithashtu, subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij depozitë në datën 28.12.2009, shumë prej 714.900 lekësh.

1.103. Komisioni vlerëson se këto vlera monetare, të cilat nuk janë përfshirë në analizën për këstin e parë, duket se kanë qenë të mjaftueshme për shlyerjen e kështit të dytë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti në vlerën 368.500 lekë¹⁵.

Analiza e treguesve financiarë për këtë pasuri

1.104. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerësimin e mësipërm ligjor, lidhur me huat dhe kohën e pagimit të kësteve të kësaj pasurie, prapësimeve dhe provave të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe verifikimin e kryer për burimet financiare të deklaruara për blerjen e pasurive, shtesat në likuiditete dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2009 – 12.11.2009, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për pagesën e shumës 8.631.500 lekë në datën 12.11.2009, lidhur me mundësinë financiare të pagimit të çmimit të apartamentit me sip.119.3 m², në rrugën “****”, Tiranë.

Analiza e treguesve financiarë për periudhën	Rezultati përfundimtar
Periudha	1.1.2009 – 12.11.2009
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga paga e subjekti transferuar në “Tirana Bank” për periudhën	701.231
Të ardhurat <i>neto</i> nga paga e bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” për periudhën	570.355
Të ardhura nga interesa depozitë në “Raiffeisen Bank” për periudhën	16.245
Të ardhura nga shitje autoveture “****”, *** (më 31.5.2009) vlerësuar	250.000
Hua nga z. Sh.R vlerësuar nga Komisioni	0

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁵Për të cilën nuk ka datë të saktë pagese.

Hua nga z. A.Z vlerësuar nga Komisioni	4/000.000
Total të ardhura /të hyra financiare	1.537.831
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	142.099
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	354.838
Total shpenzime/të dala financiare	496.936
Ndryshim mj. monetare cash deklaruar gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-232.015
Mjete monetare të disponueshme (1)	808.880
Blerje ap. banimi, me sip. 119,3 m ² , në rrugën “****”, Tiranë (kontratë datë 12.11.2009)	9.000.000
Blerje autoveturë “****” (më 23.3.2009)	500.000
Detyrime shoqërisë ndërtimore	368.500
Pasuri neto (2)	9.131.500
Balanca e fondeve (1-2)	-4.322.620

1.105. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimet financiare të ligjshme për pagesën e shumës 8.631.500 lekë në datë 12.11.2009, pjesë e çmimit të apartamentit me sip.119.3 m², në rrugën “****”, Tiranë dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruar dhe të evidentuara, për periudhën 1.1.2009 – 12.11.2009, duke rezultuar me balancë negative në vlerën -4.322.620, dhe duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 119 m², rruga “****”, Tiranë

2.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar, apartament banimi me sipërfaqe 119 m², porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 3.9.2010, me investitor shoqëria “****” sh.p.k., porositës V.R, me adresë rruga “****”, Tiranë, e përfutur nga kontrata e sipërmarrjes me palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k., me palë porositësi trashëgimtarët e familjes C., krahas tyre V.R si bashkëpronare, nr. ***, datë 4.5.2010, duke përfutur apartament me sipërfaqe 119 m², e cila i zbritet nga pjesa takuese e 30% të sipërfaqes ndërtimore në pasurinë prej 60.000 m², që i është dhënë shoqërisë “****” sh.p.k., për ndërtimin e fshatit turistik në ***, Durrës.

2.2. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: kontratë sipërmarrje me nr. ***, datë 4.5.2010, me shoqërinë “****” sh.p.k., me palë trashëgimtarët e familjes C., krahas tyre (bashkëshortja V.R si bashkëpronare, trashëgimtare ligjore), ku i vihet në dispozicion shoqërisë “****” sh.p.k., një sipërfaqe prej 60.000 m², për ndërtim fshati turistik, përkundrajt kalimit në pronësi të pronarëve të truallit, të 30% të ndërtimit në ***, Durrës. Pjesa takuese: 1/60 pjesë V.R.

2.3. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: Aneks kontratë sipërmarrje me nr. ***, datë 22.10.2016, lidhur midis palës sipërmarrëse shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës porositëse V.R, J.G, për përcaktimin e sipërfaqes ndërtimore që i takojnë pronarëve në vijim të kontratave të sipërmarrjes. Sipas këtij aneksi kontratë, personi i lidhur bashkëshortja e subjektit ka rënë dakord për pjesët përfituese në sipërfaqe ndërtimi nga kontratat e sipërmarrjes, pas zbritjes të apartamentit me sip. 119.21 m² me kontratën e sipërmarrjes për apartament banimi me nr. ***, datë 3.9.2010, me investitor shoqërinë “****” sh.p.k., porositës V.R.

2.4. Në DVP-në e vitit 2010, subjekti, në formularin e ndryshimeve të interesave private, ka deklaruar:

- Kontratë sipërmarrje, nr. ***, datë 4.5.2010, me shoqërinë “****” sh.p.k., me palë trashëgimtarët e familjes C., krahas tyre (bashkëshortja V.R si bashkëpronare, trashëgimtare ligjore), ku i vihet në dispozicion shoqërisë “****” sh.p.k., një sipërfaqe prej 60.000 m², për ndërtim fshati turistik, përkundrejt kalimit në pronësi të pronarëve të truallit, të 30% të ndërtimit në ***, Durrës.

2.5. Referuar kontratës së sipërmarrjes, nr. ***, datë 3.9.2010, për apartament banimi, me sip. 119 m², në rrugën “****”, me investitor shoqërinë “****” sh.p.k., porositës V.R, e përfituar nga kontrata e sipërmarrjes me palë sipërmarrëse: shoqëria “****” sh.p.k., me palë porositëse trashëgimtarët e familjes C., krahas tyre personi i lidhur si bashkëpronare me nr. ***, datë 4.5.2010, duke përfituar apartament me sipërfaqe 119 m², e cila i zbritet nga pjesa takuese e ndërtimit në fshatin turistik në ***, Durrës.

2.6. UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2020, informon se znj. V.R ka kontratën me nr. ***, për objektin në adresën rruga “****”, Tiranë, me status aktiv, e kategorisë familjare, me detyrime të likuiduara deri në dhjetor të vitit 2019, ndërsa për subjektin e rivlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për kontratë.

2.7. Me vendimin nr. ***, datë 11.7.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është çelur dëshmia e trashëgimisë së trashëgimlënësit të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit shtetasit S.G. Sipas këtij vendimi rezulton se një nga trashëgimtarët ligjore është bashkëshortja e subjektit, e cila trashëgon 1/3 pjesë e pasurisë së trashëgimlënësit S.G.

2.8. Referuar informacionit të përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë¹⁶, subjekti ka gjykuar dhe marrë vendim në:

i) Çështjen me nr. ***, datë 25.8.2017, me palë paditës: shoqëria “****” sh.p.k., i paditur: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, objekt: marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ, vendimeve për pezullimin e punimeve nr. ***, datë 21.8.2017, nr. ***, datë 21.8.2017, nr. ***, datë 21.8.2017, nr. *** datë 21.8.2017 dhe nr. ***, datë 21.8.2017, të IKMT-së; pezullimin e marrjes së vendimeve të tjera për këto objekte. Në datën 29.8.2017 subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë duke urdhëruar pezullimin e zbatimit të akteve administrative të nxjerra nga IKMT-ja, si dhe pezullimin e marrjes së vendime të tjera për këto objekte nga IKMT-ja. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 6.12.2018, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të shkallës së Parë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës për marrjen e sigurimit të padisë si të pa bazuar në ligj.

ii) Çështjen me nr. ***, datë 25.8.2017, me palë paditës: shoqëria “****” sh.p.k., i paditur Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, objekt: marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ, vendimeve për pezullimin e punimeve nr. ***, datë 21.8.2017 dhe nr. ***, datë 21.8.2017, të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, pezullimin e marrjes së vendimeve të tjera për këto objekte. Në datën 29.8.2017 subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë duke urdhëruar pezullimin e zbatimit të akteve administrative të nxjerra nga IKMT-ja, si dhe pezullimin e marrjes së vendime të tjera për këto objekte nga IKMT-ja. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 13.2.2018, duke vendosur rrëzimin e kërkesës për marrjen e sigurimit të padisë si të pa bazuar në ligj.

¹⁶Shkresë nr. *** prot., date 4.11.2021, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kthim përgjigje dhe dhënie vendimesh.

2.14. Me shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2022, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vënë në dispozicion të Komisionit kopje të vendimit nr. ***, datë 13.2.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. regj.***, datë 29.8.2017, të Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë si dhe kopje të vendimit nr. ***, datë 6.12.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili ka ndryshuar vendimin nr. *** akti, datë 29.8.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke rrëzuar kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

2.15. Po ashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen gjyqësore të themelit të çështjes, e cila ka për objekt konstatimin e pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të nxjerra nga IKMT-ja, për të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesë padisë duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të IKMT-së. Ky vendim është ankimuar nga pala e paditur IKMT dhe dosja ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit.

2.16. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit është në një marrëdhënie të vazhdueshme interesi me shoqërinë “****” sh.p.k., ku sipas Aneks Kontratës së sipërmarrjes me nr. ***, datë 22.10.2016, lidhur më shoqërinë ndërtimore “****” sh.p.k. thuhet: *“Palët kontraktuese bien dakord që pjesa e përfutur shtesë nga bashkëpronarja V.R për plotësimin e sipërfaqes së apartamenteve të mësipërme në sipërfaqen prej 4.99 m², do t’i zbritet asaj nga pjesa takuese që do të përfitojë nga ndërtimi që do të realizohet pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes nga bashkëpronarët C. me investitorin ‘****’ sh.p.k., për sipërfaqen rreth 19 ha e ndodhur në ***”.*

2.17. Në DPV-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrje, nr. ***, datë 30.4.2017, lidhur midis shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k. me administrator D.D, me palë porositësi: trashëgimtarët e familjes C., midis tyre bashkëshortja V.R, ku i vënë në dispozicion shoqërisë “****” sh.p.k. një sipërfaqe prej 189.292 m² për ndërtimin e një strukture turistike polifunksionale, kundrejt përfitimit nga bashkëpronarët (midis tyre V.R) të 25% të sipërfaqes së ndërtimit.

2.18. Po ashtu, edhe kontrata e shkëmbimit për pasuri të paluajtshme (pronare trualli-sipërmarrës), nr. ***, datë 21.10.2020, mes palëve sipërmarrëse shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., me palë porositëse trashëgimtarët e familjes C., e depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4, tregon që marrëdhënia e interesit midis bashkëshortes së tij dhe shoqërisë “****” ka vazhduar edhe pas vitit 2017, ku subjekti ka gjykuar dhe ka marrë vendim në çështjet në të cilat shoqëria “****” ka qenë palë ndërgjyqëse.

2.19. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës, për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se: Subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit në gjykimin dhe vendimmarrjen e çështjeve administrative me nr. ***, datë 25.08.2017; nr. ***, datë 25.8.2017 dhe nr. ***, datë 4.9.2017¹⁷.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

2.20. Subjekti, në prapësimet e tij në lidhje me barrën e provës për konfliktin e interesit, ndër të tjera, sqaron se: *“Bazuar në ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar, duke vlerësuar marrëdhënien që bashkëshortja ime V.R, ka pasur me palën kërkuese çmova se duhet të paraqisja dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështje. Për këto arsye, në vështrim të nenit 72/4 dhe 73 të Kodit të Procedurave Civile dhe vendimit nr. ***, datë 24.12.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i kam kërkuar*

¹⁷Vendimet (JR) nr. 10/2019 dhe (JR) nr. 18/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

*Kryetari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të miratonte heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative, me palë ndërgjyqëse: paditës shoqëria *** sh.p.k. Me vendimin nr. ***, datë 8.9.2017, kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur: mospranimin e kërkesës për heqje dorë të gjyqtarit Emiljano Ruli, nga çështja”.*

Neni 72, pika 1, e Kodit të Procedurave Civile përcakton se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete, kur ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim. Sipas kësaj dispozite duhet të ekzistojë një çështje ose mosmarrëveshje tjetër gjyqësore, që ka lidhje me atë në gjykim. Unë nuk kam pasur interes në asnjë çështje tjetër gjyqësore që lidhej me atë në gjykim. Neni 72, pika 3, e Kodit të Procedurave Civile përcakton se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve. Sipas përcaktimit të këtij neni, unë me palën kërkuese nuk kam pasur asnjë marrëdhënie kredie apo huaje, por bashkëshortja ime ka pasur një marrëdhënie kontraktore sipërmarrje, e cila sikurse do ta shpjegojë më poshtë, kishte përfunduar. Neni 72, pika 6, e Kodit të Procedurave Civile përcakton se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie. Sipas kësaj dispozite dhe paragrafit 7, të nenit 72, të Kodit të Procedurave Civile vërtetimin e arsyeve serioze e bën kryetari i gjykatës, të cilit i paraqitet kërkesa për heqjen dorë dhe ai vendos. Kryetari ka vendosur mospranimin e kërkesës për dorëheqje.

*2. Në lidhje me kontratën e sipërmarrjes¹⁸ me palë sipërmarrëse shoqërinë “***” sh.p.k., me nr. ***, datë 30.4.2017, është e vërtetë që kjo kontratë mban datën 30.4.2017, por kjo ka qenë një kontratë premtimi për dhënien për zhvillim të pronës dhe në muajin gusht e shtator të vitit 2017 unë kam zhvilluar proceset gjyqësore, nuk kam qenë në dijeni të kësaj kontrate. Kjo për faktin se unë nuk kam qenë nënshkrues i saj, por ka qenë bashkëshortja. Kam marrë dijeni për këtë kontratë kur po plotësoja DVP e vitit 2017. Në nenin VII, pika 4, kontrata ka pasur afat 1-vjeçar dhe kushtëzohej me marrjen e lejes së ndërtimit nga pala sipërmarrëse, me kushtin e zgjidhjes nëse nuk merrej leja. Sikurse rezulton leja e ndërtimit nuk është marrë brenda afatit nga ana e shoqërisë dhe kjo kontratë për efekt të ligjit ishte zgjidhur. Nga kontrata e mësipërme, nuk rrjedhin interesa private konkrete, të përcaktuara ose të përcaktueshme, sepse vazhdimësia e saj është e kushtëzuar nga marrja e lejes së ndërtimit dhe nga lidhja e kontratave të mëpasshme për përcaktimin e pjesëve takuese. Pas përfundimit të kontratës, nr. ***, datë 30.4.2017, me kalimin e afatit 1-vjeçar për marrjen e lejes së ndërtimit, marrëdhënia me shoqërinë “***” sh.p.k. është ndërprerë.*

*Në kushtet kur nuk është arritur marrëveshje me asnjë ndërtues tjetër, bashkëpronarët kanë pranuar që këtë pasuri ta japin përsëri për zhvillim të shoqëria “***” sh.p.k., por tashmë, duke ndryshuar kushtet e kontratës. Konkretisht, numri i pasurive që i është dhënë për zhvillim është zvogëluar, si dhe pjesa takuese e pronarëve të tokës në përqindje është rritur.*

*Konkretisht, në vitin 2020 është lidhur aneks kontrate sipërmarrje¹⁹, nr. ***, datë 7.1.2020, me palë sipërmarrëse shoqëria “***” sh.p.k. Edhe në këtë aneks kontratë, serish duhej të plotësohej kushti i marrjes së lejes së ndërtimit, e cila u realizua nga shoqëria “***” sh.p.k. Aktualisht shoqëria është në fillimet e kryerjes së punimeve në lidhje me Kompleksin Turistik ***, për pasojë prona është ende në zhvillim dhe nuk është në kushtet e përfitimit të pjesëve takuese nga ana e*

¹⁸Bashkëngjitur gjeni në cilësinë e provës: kontratë sipërmarrje me nr.***, datë 30.4.2017, kontratë premtimi për dhënien për zhvillim të pronës.

¹⁹Bashkëngjitur gjeni në cilësinë e provës: aneks kontrate sipërmarrje nr. ***, datë 7.1.2020.

pronarëve. Përveç sa më sipër, nga ana ime, nuk mund të parashikohej në vitin 2017 se çfarë do të ndodhte në vitin 2020, që të vlerësoja se isha në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.21. Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi dokumentacionin në lidhje me situatën e konfliktit të e interesit, dëgjoi prapësimet e subjektit në funksion të barrës së provës²⁰, duke u orientuar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²¹, vlerëson se:

2.22. Nga rrethanat e çështjes është fakt që bashkëshortja e subjektit ka filluar marrëdhënien juridike pasurore me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes me nr. ***, datë 4.5.2010, si një nga trashëgimtarët e familjes C., ku i vihet në dispozicion shoqërisë “****” sh.p.k., një sipërfaqe prej 60.000 m², për ndërtim fshati turistik, përkundrejt kalimit në pronësi të pronarëve të truallit, të 30% të ndërtimit në ***, Durrës.

2.23. Marrëdhënia juridike pasurore ka vijuar, më tej, me lidhjen e kontratës për ndërtimin e një apartamenti banimi me sipërfaqe 119 m², porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 3.9.2010, me investitor shoqëria “****” sh.p.k., porositës V.R, me adresë rruga “****”, Tiranë, duke përfituar apartament me sipërfaqe 119 m², e cila i zbritet nga pjesa takuese e 30% të sipërfaqes ndërtimore në pasurinë prej 60.000 m², që i është dhënë shoqërisë “****” sh.p.k., për ndërtimin e fshatit turistik në ***, Durrës.

2.24. Bashkëshortja e subjektit vazhdoi marrëdhënien pasurore me këtë shoqëri me nënshkrimin e një kontratë tjetër sipërmarrje me nr. ***, datë 29.6.2012, e cila së bashku me bashkëpronarët e tjerë do t’i vinte në dispozicion shoqërisë “****” sh.p.k. një sipërfaqe toke për ndërtimin e fshatit turistik, kundrejt kalimit në pronësi të pronarëve të truallit, të 30% të ndërtimit.

2.25. Komisioni vërejt se në deklaratën *Vetting* subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar lidhjet e kontratave të sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka depozituar në cilësinë e provës kontratën e shkëmbimit, nr. ***, datë 21.10.2020, e cila në objektin e saj përcakton se: *“Kjo kontratë është ekzekutim i kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 29.6.2012, dhe marrëveshjes së bashkësipërmarrësve me nr. ***, datë 31.03.2015”*. Në nenin 2 kontrata ka të përcaktuar sipërfaqen ndërtimore objekt shkëmbimi. Në listën e bashkëpronarëve që përfiton sipërfaqe ndërtimi me nr. *** është bashkëshortja e subjektit, e cila përfiton vilë me sipërfaqe 135 m², në ***, Durrës.

2.26. Rezultoi e provuar se marrëdhënia me shoqërinë “****” sh.p.k. ka vazhduar deri në vitin 2020, për kontratën e sipërmarrjes të lidhur në vitin 2012, kohë kur është nënshkruar edhe kontrata e shkëmbimit, fakt ky, i cili nuk është pasqyruar në mënyrë të saktë në kërkesën për dorëheqje që i është relatuar kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke pretenduar se marrëdhënia juridiko-pasurore kishte përfunduar midis bashkëshortes dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., para gushtit të vitit 2017.

²⁰Neni 52/2 i ligjit nr. 84/2016, parashikon: *“Nëse Komisioni ose Kolegji i Posaçëm i Apelimit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”*.

²¹ “[...] Komisioni duhej t’i referohej parimeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencës së GJEDNJ, bazës ligjore në legjislacionin tonë të brendshëm, Kodit të Procedurës Civile, për të përforcuar konkluzionet mbi gjendjet faktike dhe ligjore të situatave të konfliktit të interesave...[...], vendim nr. 16/2019 (JR)”.

2.27. Komisioni konstaton se në kohën e shqyrtimit të çështjeve me palë paditëse shoqërinë “****” sh.p.k., jo vetëm që nuk kishin përfunduar marrëdhëniet juridike-pasurore, në lidhje me dy kontratat e sipërmarrjes të lidhura në vitet 2010 dhe 2012, pasi u vërtetuan nga kontrata e shkëmbimit e vitit 2020, por këto marrëdhënie ishin përforcuar edhe nga kontrata e re e sipërmarrjes që kishte lidhur personi i lidhur me shoqërinë “****”, në prill të vitit 2017, afërsisht rreth 4 muaj para shqyrtimit të çështjeve nga subjekti.

2.28. Në kuptim të nenit 5, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 9367, i ndryshuar apo të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, kjo marrëdhënie juridiko-civile me karakter pasuror, përbën interes privat të zyrtarit/gjyqtarit. Përderisa rezulton ekzistenca e interesave privatë në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, atëherë shtrohet për diskutim ekzistenca e konfliktit të interesit në rastin konkret, për sa kohë që konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Duke pasur parasysh marrëdhënien e drejtpërdrejtë juridiko-civile me karakter pasuror, mes subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., e trajtuar në raport subjekti ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në këtë vendimmarrje gjyqësore, pasi edhe marrëdhënia kontraktore mes subjektit dhe palës ndërgjyqëse, shoqërisë “****” sh.p.k., nuk kishte përfunduar në momentin e shqyrtimit të tri çështjeve me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k.

2.39. Në konkluzion të analizës së sipër, trupi gjykues arrihen në përfundimin se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, kur ka gjykuar tri çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k., duke e vendosur atë në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “d”, e ligjit nr. 84/2016.

3. Automjet tip “**”, blerë në vitin 2015**

3.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* automjetin tip “****”. Çmimi i blerjes është 1.500.000 lekë, blerë me kontratë shitblerje automjeti me nr. ***, datë 11.3.2015, me shitës D.D, blerëse Emiljano Ruli, V.R.

3.2. Në DPV-në e vitit 2015, në ndryshimet e pasurisë, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar:

- blerje automjeti tip “****”, çmimi i blerjes 1.500.000 lekë, është transferuar nga llogaria e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e shtetases P.A;
- shitje automjeti tip “****”, çmimi i shitjes 900.000 lekë;
- shitje automjeti tip “****”, në çmim 100.000 lekë.

3.3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresë kthim përgjigje ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 30.6.2017, konfirmon, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë në pronësi mjetin me targa ***.

3.4. Me kontratën e shitblerjes, nr. ***, datë 11.3.2015 (notere D.P), subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë nga shtetasi D.D, automjetin “**** tip ***” (***), vit prodhimi 2013, me targa ***, kundrejt çmimit 1.500.000 lekë (shumë të cilën shitësi deklaroi se e ka marrë nga blerësi nëpërmjet kalimit bankar para redaktimit të kontratës).

3.5. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 11.3.2015, nga llogaria e znj. V.R (bashkëshorte e subjektit) është transferuar shuma prej 1.500.000 lekë, me përfitues znj. P.A, me përshkrim “për blerje automjeti”.

3.6. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë shpjegime, për sa duket se ka mospërputhje në lidhje me personin në të cilin është transferuar shuma prej 1.500.000 lekësh, pasi nuk evidentohet as në cilësinë e blerësit/të autorizuarit dhe as të noterit.

Analizë e burimit të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

3.7. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, ndër të tjera, subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga; (ii) shumën prej 900.000 lekësh të transferuara në datën 2.2.2015 nga shtetasi A.K në “Credins Bank”, pas blerjes së automjetit nga ky i fundit; (iii) shuma e përfituar si bonus nga bashkëshortja nga “****” sh.p.k., e depozituar më 31.10.2011.

3.8. Në DPV -në e vitit 2015, nuk është deklaruar burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj autoveture. Subjekti, në pyetësin nr. 2, ndër të tjera, deklaroi se: *“Burimi i krijimit të kësaj shume janë 900.000 lekë përfituar nga kontrata e shitblerjes së automjeti me nr. ***, datë 2.2.2015, me palë shitëse Emiljano Ruli, V.R, me palë blerëse A.K, dhe pjesa tjetër gjendje në llogarinë e bashkëshortes V.R, në Raiffeisen Bank”*.

3.9. Subjekti ka bashkëlidhur si prova kontratat e shitblerjeve të të gjitha automjeteve.

3.10. Referuar dokumentacionit të disponuar, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, nga Komisioni u krye një analizë paraprake e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015-11.3.2015, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për pagesën e shumës prej 1.500.000 lekësh, për blerjen e automjetit “Mercedes Benz ****”, konkretisht:

i) Të ardhura nga paga, gjendje në llogari në “Raiffeisen Bank”

3.11 Në të ardhura nga paga, për periudhën 1.1.2015-11.3.2015, subjektit dhe bashkëshortes i janë transferuar në llogaritë përkatëse bankare (në BKT dhe “Raiffeisen Bank”), përkatësisht shumat 265.061 lekë dhe 189.705 lekë.

ii) Të ardhura nga shitja e autoveturës tip “*”, me targa ******

3.12. Me kontratë shitblerje automjeti, me nr. ***, datë 2.2.2015, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur (bashkëshorten) dhe blerës shtetasin A.K, është shitur automjeti tip “****”, me targa ***, kundrejt çmimit prej 900.000 lekësh. Çmimi i blerjes është transferuar nga shitësi A.K nëpërmjet “Credins Bank”, në llogarinë e bashkëshortes V.R, në “Raiffeisen Bank”.

3.13. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se në llogarinë e bashkëshortes është transferuar shuma 900.000 lekë, në datën 2.2.2015, nga shtetasi A.K, me përshkrim “blerje automjeti”.

Në lidhje me blerjen dhe shitjen e automjetit tip “*”, me targa ******

3.14. DPSHTRR-ja konfirmon se shtetasit Emiljano dhe V.R kanë pasur në bashkëpronësi automjetin me targa ***, deri në datën 4.2.2015 dhe vë në dispozicion dosjen e këtij automjeti:

i) faturë shitje nr. ***, datë. 19.11.2010, për automjet tip “Daimler – Chrysler”. Blerës B.Z, shitës M.B. Çmimi 9.000 euro, deklaratë doganore ***, datë 7.12.2010 me detyrime doganore në shumën 579.570 lekë;

ii) kontratë shitblerje nr. ***, datë 5.3.2011, për automjet “****”, shitës B.Z, blerës Emiljano dhe V.R, çmimi i shitjes 7.000 euro;

iii) kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë. 2.2.2015, për automjet tip “****”, me targa ***, shitës Emiljano dhe V.R dhe blerës A.K, çmimi 900.000 lekë i likuiduar.

3.15. Automjeti me targa *** është blerë fillimisht nga shtetasi B.Z në datën 19.11.2010, me çmimin 9.000 euro dhe ky shtetas ka paguar dhe detyrimet doganore në datën 7.12.2010, kundrejt shumës 579.570 lekë (duke rezultuar në total se ka paguar për këtë automjet vlerën 1.827.420 lekë ose konvertuar rreth 13.180 euro),

3.16. Ky automjet i është shitur rreth tre muaj nga zhdoganimi i tij në datën 5.3.2011, subjektit Emiljano Ruli, me çmimin 7.000 euro.

3.17. Në pyetësoin nr. 3, në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti, ndër të tjera, subjekti sqaron se: *“... në shkurt të vitit 2011, kam shkuar te tregu i makinave në Shijak aty kam parë automjetin tip ***, pas interesimit rezultoi se ishte në pronësi të shtetasit B.Z. Pas kontrollit të mjetit rezultoi se ai kishte një diferencë e madhe (rreth 2.5 herë më shumë) ndërmjet kilometrave që kishte të regjistruara te matësi i kilometrazhit, për këtë arsye, u ble me çmimin 7.000 euro”.*

3.18. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij automjeti, subjekti shpjegon se: *“Sipas marrëveshjes me vëllain J.G të cilit i kishim shitur paraprkisht automjeti tip veture, marka ‘****’, targa *** (ndërsa me akt noterial është bërë me kontratën nr. ***, datë 30.12.2011), pjesën takuese të tij nga shitja e pasurisë prej 2.500 euro, ja kalonte të motrës, në funksion të blerjes së automjetit tip veture, tip “Volkswagen Passat”, targa ***. Po kështu vëllai i bashkëshortes J.G, diferencën e mbetur prej 7.500 euro, nga çmimi 10.000 euro, me të cilin ju shit automjetit tip veture, marka ‘****’, targa ***, ja ka dhënë bashkëshortes paraprkisht. Pra, 4.500 Euro nga çmimi i shitjes 10.000 euro të automjetit ‘****’, janë përdorur për blerjen e automjetit i llojit ‘****’ ***, në shumën 7.000 euro. Diçka me pak se 3.000 euro (shuma konkrete dhe data, nuk më kujtohet), janë përdorur për t’i shlyer shtetasit E.F në vitin 2011, shpenzimet e kryera për riparimin tërësor të mjetit ‘****’. Diferenca prej rreth 2.500 euro, është përdorur pjesërisht për mobilimin e shtëpisë (apartamentit të banimit) dhe pjesërisht për të përballuar shpenzimet e jetesës”.*

Në lidhje me blerjen dhe shitjen e automjetit tip “*”, me targa ******

3.19. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar kontratë blerje automjeti, datë 23.3.2009, tip “****”, me vlerë blerje 500.000 lekë.

3.20. Në bazë të kontratës së shitjes automjeti të datës 23.3.2009, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë nga shtetasi A. M., automjetin tip “****”, kundrejt vlerës prej 500.000 lekë të likuiduar me firmosjen e kontratës.

3.21. Ky automjet (me targa ***), referuar kontratës së shitjes së datës 30.12.2012, nga subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshortja), i është shitur shtetasit J.G (vëllait të bashkëshortes), kundrejt çmimit 10.000 euro, shumë e cila është likuiduar nga blerësi para redaktimit të kontratës e jashtë zyrës noteriale.

3.22. Në lidhje me këtë automjet, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Automjeti tip ‘****’, blerë me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 23.3.2009, ka qenë prodhim i vitit 2004-2005 dhe është blerë në gjendje të dëmtuar, prandaj ka pasur atë çmim.*

*Automjeti është riparuar nga ana ime në servis dhe me shpenzime të vogla, të shtrira në kohë. Një nga ortaket e shoqërisë “***” sh.p.k. shtetasi E.F, me të cilin kam njohje, ka në pronësi autoservis “***”. Në fillim të vitit 2009, me ka njoftuar se tek servisi i tij është paraqitur një automjet tip “***”, i dëmtuar, të cilin pronari donte ta shiste me çmim të leverdishëm. Pasi kam parë automjetin, kam refuzuar sepse ai ishte shumë i dëmtuar. Shtetasi E.F, me ka garantuar se automjetin do ta riparonte ai me pak shpenzime dhe pagesën mund ta bëja kur të kisha mundësi. Mjeti është riparuar, ka dalë në gjendje shumë të mirë motorrike dhe xhenerike.*

Shpenzimet e kryera për riparimin janë rreth 3.000 euro. Këto i janë shlyer shtetasit E.F, në vitin 2011, pasi kam përfituar shumën prej 7.500 euro, nga shitja e automjetit kunatit (vëllait të gruas) J.G. Shuma e mësipërme është likuiduar cash nga vëllai i bashkëshortes J.G.”

3.23.Referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurive të personit të lidhur, bashkëshortes së tij. Më konkretisht në nenin 4, germa “d”, të këtij ligji përcaktohet se subjekti detyrohet të deklarojë: “... vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.

3.24. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës, për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

i) blerja e automjetit tip “***”, nga ana e subjektit dhe bashkëshortes në datën 11.3.2015 deklaruar në deklaratën *Vetting*, në vlerën 1.500.000 nuk u arrit të provohet lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit për sa kohë ai është i lidhur me transaksione të mëparshme të automjeteve, si vijon:

- Si burim krijimi për këtë automjet, subjekti ka deklaruar se janë përdorur të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***.

- Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk krijojnë bindjen e trupit gjykues për vlerat reale të shitjes dhe blerjes së këtij automjeti, pasi shitësi B.Z e ka blerë automjetin në fund të vitit 2011, në vlerën totale prej 13.180 euro dhe ia ka shitur subjektit në shumën 7.000 euro në datë 5.3.2011. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar defektet e pretenduara të këtij automjeti për një periudhë 3-mujore, të cilat kanë sjelle zvogëlimin e vlerës për rreth 50% të saj.

- Ky automjet është shitur në vitin 2015, në vlerën 900.000 lekë dhe subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë shpenzimet e bëra për rritjen e vlerës së automjetit, për shitjen e tij me të madhe se ajo e blerjes në vitin 2011, pasi automjeti ka qenë rreth 4 vjet në qarkullim.

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar defektet e pretenduara të këtij automjeti për një periudhë 3-mujore, të cilat kanë sjellë zvogëlimin e vlerës për rreth 50% të saj dhe, për rrjedhojë, çmimi i referuar në këtë kontratë dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse lidhur me vlerën reale të blerjes dhe shitjes së këtij mjeti.

- Si burim për blerjen e automjetit “***” në datën 5.3.2011 ka shërbyer shitja e një automjeti tjetër nga ana e subjektit dhe bashkëshortes blerë në vitin 2009 në vlerën 500.000 dhe shitur vëllait të bashkëshortes në shumën 10.000 euro, në datën 30.12.2012.

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar shpenzimet për mirëmbajtje dhe përmirësim të kryera për këtë mjet, për automjetin i cili ka qenë rreth 2 vjet në qarkullim, të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës së tij dhe, për rrjedhim, edhe çmimi i referuar në këtë kontratë, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse lidhur me vlerën reale të shitjes së mjetit.

3.25. Transaksionet e sipërcituara lidhur me automjetet nuk krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerat reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe duket se ato në të vërtetë përbëjnë veprime financiare të pajustificuara.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

3.26. Subjekti, në prapësimet e tij, ndër të tjera sqaron se: *“Sipas konstatimit të Komisionit, si burim krijimi për këtë automjet subjekti ka deklaruar se janë përdorur të ardhurat nga shitja e makinës me targa ***. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerat reale të shitjes dhe blerjes së këtij automjeti pasi shitësi B.Z e ka blerë automjetin në fund të vitit 2011, në vlerën totale prej 13.180 euro dhe ia ka shitur subjektit në shumën 7.000 në datën 5.3.2011, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar defektet e pretenduara të këtij automjeti, të cilat për një periudhë 3-mujore kanë sjellë zvogëlimin e vlerës së tij me 50% të saj. Kam dhënë shpjegimet në pyetësorin nr. 2 dhe 3. Ky automjet është blerë me kontratën e shitblerjes me nr. ***, datë 5.3.2011, me palë shitëse B.Z, me çmim 7.000 euro. Çmimi ishte i ulët pasi shitësi kishte ndërhyrë te kilometrazhi i automjetit, fakt ky që u zbulua nga servis “***”, prandaj edhe çmimi shitjes u ul në vlerën 7.000 euro.*

3.27. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se si burim për blerjen e automjetit tip “***” në datën 5.3.2011 ka shërbyer shitja e një automjeti tjetër nga subjekti dhe bashkëshortja, blerë në vitin 2009, në vlerën 500.000 dhe shitur vëllait të bashkëshortes në vlerën 10.000 euro, në datën 30.12.2012, subjekti shpjegon se: *“Në lidhje me diferencën që ekziston ndërmjet çmimit prej 500.000 lekësh të blerjes dhe atij prej 10.000 euro të shitjes kam dhënë shpjegime të hollësishme në kthim përgjigje të pyetësorit nr. 3. Automjeti tip ‘***’, blerë me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 23.3.2009, ka qenë prodhim i vitit 2004 -2005 dhe është blerë në gjendje të dëmtuar, prandaj është blerë me vlerë aq të vogël. Automjeti është riparuar nga ana ime në servis dhe me shpenzime shume të vogla, e të shtrira në kohë. Në lidhje me këtë fakt shoqëria ‘***’ sh.p.k., datë 22.11.2021, me shkresë bën me dije se: ‘... automjetit i janë ndërruar parakolpi, kofano, radiatorit i motorit, sistemi i parë i lëvizjes. Janë drejtuar katër disqet, janë ndërruar ferrotat dhe disqet e frenimit, janë stukuar pothuajse të katërta dyert dhe prapakolpi, si dhe është lyer tërësisht e gjithë makina. E gjithë vlera për riparimin e makinës shkonte diku tek 5.000 euro, por për shkak të njohjes që kisha me z. Ruli, faktin se pjesën më të madhe të pjesëve të këmbimit unë i kisha siguruar në varrezat e makinave, ndërsa një pjesë i tregtoj vetë dhe i kam dhënë çmime preferenciale, po kështu lyerjen e makinës e kam bërë në servisim tim, pas uljes që i kam bërë, vlera shkonte rreth 3000 euro’. Sa më sipër, çmimi i blerjes dhe ai i shitjes së automjetit, është deklaruar rregullisht nga ana ime, pa pasur asnjë qëllim për fshehjen e tij dhe është paguar realisht nga ana e blerësit, për pasojë nuk ka asnjë dyshim mbi faktin se vlera reale e çmimit të blerjes së automjetit në gjendje të dëmtuar ka qenë 500.000 lekë, ndërsa ajo e shitjes pas riparimit ka qenë 10.000 euro”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.28. Trupi gjykues i Komisionit, mbështetur në provat e administruara, në deklaratimet e subjektit në pyetësorë dhe në deklarinimin në deklaratën *Vetting*, arsyeton se:

3.29. Blerja e automjetit tip “***” nga subjekti dhe bashkëshortja në datën 11.3.2015, deklaruar në deklaratën *Vetting*, në vlerën 1.500.000, nuk u arrit të provohet lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit, për sa kohë ai është i lidhur me transaksione të mëparshme të automjeteve, si vijon:

3.30. Si burim krijimi për këtë automjet subjekti ka deklaruar se janë përdorur të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë vlerat reale të shitjes dhe blerjes së këtij automjeti për sa shitësi B.Z e kishte blerë automjetin në fund të vitit 2011 në vlerën totale prej 13.180 euro dhe ia kishte shitur subjektin në shumën 7.000 euro, në datën 5.3.2011 dhe për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk provoi as defektet e pretenduara të këtij automjeti për një periudhë 3-mujore, të cilat kanë sjellë zvogëlimin e vlerës për rreth 50% të saj dhe as shpenzimet e bëra, të cilat sollën rritjen e vlerës së automjetit për shitjen e tij më të madhe se ajo e blerjes në vitin 2011, pasi automjeti ka qenë rreth 4 vjet në qarkullim, duke u shitur në vitin 2015 në vlerën 900.000 lekë.

3.31. Duke mbajtur në konsideratë edhe transaksionin e mëparshëm lidhur me automjetet, ku si burim për blerjen e automjetit tip “***”, në datën 5.3.2011, ka shërbyer shitja e një automjeti tjetër nga subjekti dhe bashkëshortja, i cili ishte blerë në vitin 2009 në vlerën 500.000 dhe shitur vëllait të bashkëshortes në shumën 10.000 euro në datën 30.12.2012, trupi gjykues arrin në përfundimin se vlerat reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve të mëparshme nga subjekti i rivlerësimit përbëjnë veprime financiare të pajustificuara.

3.32. Në analizë të burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* lidhur me pasurinë e luajtshme automjet tip “***”, sipas një vlerësimi tërësor të të gjitha hallkave të zinxhirit të burimit të pretenduar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, pavarësisht përpjekjeve, subjekti dështoi të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË

3.33 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se mungesa e burimeve të ligjshme financiare në vlerën -4.322.620, për të justifikuar pagesën e shumës 8.631.500 lekë, si pjesë e çmimit të apartamentit me sip.119.3 m², në rrugën “***”, Tiranë dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për harkun kohor 1.1.2009 -12.11.2009, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61 dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3.34. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar tri çështjet me palë ndërgjyqëse shoqërinë “***” sh.p.k. dhe kjo e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61 dhe germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3.35. Në analizë të burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* lidhur me pasurinë e luajtshme automjet tip “***”, sipas një vlerësimi tërësor të të gjitha hallkave të zinxhirit të burimit të pretenduar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, pavarësisht përpjekjeve, subjekti dështoi të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3.36 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bazuar në konkluzionet e arritura më lart, në konsideratë edhe të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, subjekti i rivlerësimit Emiljano Ruli nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, i cili me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2020, ka deklasifikuar raportin fillestar, ku informon sa vijon:

4.1. Referuar deklaratës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Grupi i Punës, lidhur me komponentin e figurës së z. Emiljano Sh.R, konstatoi se: *Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Pas diskutimeve të anëtarëve të Grupit të Punës u vendos dërgimi i kërkesës për verifikimin e kontrollit të figurës në Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH dhe SHÇBA.*

4.2. Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

4.3 Komisioni, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, nuk konstatoi *indicie* apo informacione, sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

KONKLUZION PËR KONTROLLIN E FIGURËS

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Emiljano Ruli ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

5. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kreu VI, nenet 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor.

ANALIZA E GJETJEVE

5.1 Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ai kualifikon drejt marrëdhënien juridike objekt shqyrtimi gjyqësor, duke orientuar gjykimin dhe arsyetimin në këtë drejtim. Njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit, siç janë parimi se barra e provës për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor i takon organit të administratës publike, parimin e kontradiktoritetit etj. Gjyqtari, kur është rasti, referon në normat kushtetuese, në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, apo vendime të Gjykatës Kushtetuese, si dhe në KEDNJ Protokollin 1 apo praktikën e GJEDNJ-së. Tri dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën administrative, ku bien në sy legjislacioni për policinë e shtetit, nëpunësin civil, për shpronësimin, ligji për urdhrin e stomatologut, legjislacioni i procedurave tatimore, kundërvajtjet administrative, legjislacioni për inspektimin e ndërtimeve etj. dhe përmbushja e detyrimeve nga marrëdhëniet e punës.

Nga ana tjetër, nga pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar katër prej tyre në gjykatat më të larta. Në 2 raste vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa në 2 raste Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe në 1 rast ka rrëzuar padinë dhe në rastin tjetër ka pranuar pjesërisht padinë. Për 3 nga 4 çështjet është paraqitur rekurs dhe dosjet ndodhen ende për gjykim pranë Gjykatës së Lartë. Në 1 rast vendimi është i paankimueshëm për shkak të ligjit.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Emiljano Ruli ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qartë dhe të kuptueshëm. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Në pjesën arsyetuese dhe në dispozitiv, ai vlerëson dhe disponon edhe për mënyrën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor sipas parashikimeve të nenit 41/b të ligjit organik nr. 49/2012.

5.2 Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 - 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke filluar nga data 4.11.2013 e aktualisht. Ai ka deklaruar se në periudhën 4.11.2013 – 7.10.2016, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i janë caktuar për gjykim 2044 çështje dhe ka përfunduar 1894 çështje, duke mbartur 79 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 92.6 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë konstatohet se subjekti ka pasur ngarkesë sasiore tepër të lartë, mbi katërfishin e standardit minimal.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Ndër pesë çështjet e vëzhguara evidentohet se seancat gjyqësore të 2 çështjeve të vitit 2016 janë regjistruar me audio ndërsa 3 çështjet e tjera janë të vitit 2014 dhe nuk janë të mbajtura me regjistrim audio. Ky fakt lidhet me instalimin audio në datën 26.6.2015, në këtë gjykatë. Ndjek radhën e veprimeve procedurale, siç përcaktohet nga ligji, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

Nga tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara evidentohet se janë ankimuar 4 vendime, nga të cilët 2 janë lënë në fuqi dhe 2 vendime janë ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila në 1 rast ka vendosur rrëzimin e padisë dhe në 1 rast ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Për 3 prej këtyre çështjeve është ushtruar edhe rekurs dhe dosjet janë ende në proces gjykimi pranë Gjykatës së Lartë.

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadija, parashtrimet, konkluzionet përfundimtare, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, urdhrat për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet përfundimtare, njoftimet (fletëthirrjet) provat etj.

5.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Emiljano Ruli dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij.

Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, gjithashtu nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave.

5.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se subjekti komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Ai ka aftësi komunikuese, shfaq sjellje etike dhe respekton solemnitetin e gjykimit.

Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. Arsyeimi i vendimeve gjyqësore ka qenë brenda afatit ligjor, që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore ka qenë në nivelin e duhur.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë në 13 seminare të organizuara nga Shkolla për një periudhë trevjeçare.

KONKLUZION PËR RIVLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE

Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, në argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues.

6. DENONCIMET

6.1 Denoncim nr. *** prot., datë 10.2.2021, i shtetasit B.M

Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit për zvarritje të procesit, paaftësi, shkelje të rënda procedurale me pasoja për paditësin dhe familjen e tij. Denoncuesi ka punuar si OPGJ pranë Prokurorisë së Përgjithshme për një periudhë 21-vjeçare. Me urdhrin nr. ***, datë 20.4.2017, “Për largim nga detyra të Oficerit të Policisë Gjyqësore” të Prokurorit të Përgjithshëm është larguar nga puna. Ky urdhër është ankimuar nga denoncuesi në gjykatë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 25.7.2017, ka vendosur: Rrëzimin e padisë së paditësit B.M si të pabazuar në ligj për mungesë të legjitimitetit pasiv, bazuar në nenet 31 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata ka rrëzuar kërkesëpadinë dhe vlerëson se ndërgjyqësia është ndërtuar gabim, pasi si palë të paditur, paditësi duhet të kishte thirrur organin e emërtesës Prokurorin e Përgjithshëm dhe jo Prokurorinë e Përgjithshme si institucion. Me vendimin nr. ***, datë 4.12.2020, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. ***, datë 25.7.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në rigjykim ka për detyrë të zhvillojë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke iu garantuar palëve të drejtën për të debatuar mbi faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm sipas parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, kryer kështu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në përfundim të të cilit t’u japë përgjigje pretendimeve të palëve duke interpretuar drejt provat, të drejtën pozitive mbi të cilat bazohen kërkimet dhe prapësimet e palëve. Gjykata Administrative e Apelit ka konstatuar se subjekti, në gjykimin e kësaj çështjeje, ka gabuar në lidhje me përcaktimin e legjitimitetit të palëve dhe, për rrjedhojë, ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektin iu kërkuar të shpjegojë dhe të paraqesë prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, shpjegon se: *“Paditësi B.M, në datën 28.7.2017 (pas vetëm 2 ditëve, nga dhënia e vendimit) ka investuar përsëri gjykatën duke paditur tashmë Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. Me vendimin nr. ***, datë 24.11.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: Pranimin e padisë pjesërisht të kërkesëpadisë. Ky vendim është ankimuar nga pala e paditur dhe me vendimin nr. ***, datë 22.4.2021, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 24.11.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Rrëzimin e padisë”, pasi paditësi ka hequr dorë nga gjykimi, sipas nenit 201/a të Kodit të Procedurës Civile. Në lidhje me pretendimin e paditësit për zvarritje të procesit gjyqësor rezultoi se procesi gjyqësor është përfunduar për 2 muaj e 20 ditë, ndërkohë që ligji nr. 49/2012 nuk ka përcaktuar një afat konkret për përfundimin e gjyimit në shkallë të parë.*

Në lidhje me konstatimin se Gjykata Administrative e Apelit ka konstatuar se subjekti në gjykimin e kësaj çështjeje ka gabuar në lidhje me përcaktimin e legjitimitetit të palëve dhe, për rrjedhojë, ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor, po parashtroj se ky konstatim i Gjykatës së Apelit, tashmë nuk është më relevant dhe unë nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi, për sa kohë zgjidhja që kam dhënë është pranuar nga vetë palët ndërgjyqëse”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi dokumentacion e çështjes dhe dëgjoi subjektin, ka konstatuar se në zgjidhjen e kësaj çështjeje, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor, bazuar edhe në vlerësimin që bën Gjykata Administrative e Apelit, subjekti ka mangësi në drejtim të njohjes dhe zbatimit të ligjit procedural.

6.2. Denoncim nr. * prot., datë 31.7.2018, i shtetasit I.K**

Ky denoncim ndaj subjektit është për vendimmarrje të padrejtë dhe bashkëlidhur ankesës denoncuesi vë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 13.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Rezulton se subjekti ka shqyrtuar çështjen me palë paditëse: N.K, i paditur L.U me objekt detyrimin e ZVRPP-së Tiranë të pajisë më certifikatë pronësie trashëgimtarët ligjorë të z. A.B, sipas vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të listës së trojeve të lëshuar nga Komuna *** për regjistrimin e kryer nga ZVRPP-ja Tiranë, vendim i cili ka rrëzuar kërkesëpadinë e paditëses. Denoncuesi ankohet për shkelje të procesit dhe veprime korruptive të gjyqtarit. Me vendimin nr.***, datë 15.1.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka vendosur: Të shpallë moskompetencën lëndore dhe tokësore në gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin datë 30.4.2014 ka vendosur të ngrejë përpara Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencave lëndore në lidhje me gjykimin e çështjes me palë paditëse: N.B i paditur L.U etj., Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Komuna ***. T'i kërkojë Gjykatës së Lartë të vendosë se kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe jo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë. Pezullimin e gjykimit të çështjes administrative deri në disponimin me vendim nga Gjykata e Lartë në lidhje me çështjen e mosmarrëveshjes, së bashku me aktet t'ia dërgojë Gjykatës së Lartë brenda 5 ditëve.

Me vendimin nr. ***, datë 29.5.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në lidhje me këtë çështje ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka disponuar me rrëzim padie. Nga aktet në dosje rezulton se zbardhja e vendimit është bërë me vonesë, jashtë afatit që përcakton ligji i posaçëm nr. 49/2022. Me vendimin nr. ***, datë 15.3.2018, Gjykata e Apelit Administrativ ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 13.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë më trup tjetër gjykues. Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se padia e paditëses N.B nuk është nënshkruar nga paditësja, por është nënshkruar nga avokati i saj në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të z. I.K, sipas prokurës me nr. ***, datë 22.1.2010. Sipas procesverbalit të seancave të veprimeve përgatitore dhe gjyqësore të datave 24.3.2014, 10.4.2014, 30.4.2014, 28.10.2014, 11.11.2014, 22.12.2014, 21.1.2015, 18.2.2015, 4.3. 2015 dhe 10.3.2015 rezulton se gjykata ka legjitimuar si përfaqësues të paditëses N.B djalin e saj I.K dhe avokatin A.O, prokurë e cila mungon në aktet e fashikullit, ndërkohë që edhe ankimi është paraqitur nga avokati mbi bazën e kësaj prokure. Gjykata Administrative e Apelit konstaton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vijuar me gjykimin e çështjes, pa verifikuar legjitimitetin si përfaqësues të paditëses së z. I.K, i cili nuk ka paraqitur asnjëherë një prokurë më të cilën paditësja N.B ta këtë autorizuar atë të ngrejë padi në emrin e saj apo të emërojë avokat për të përfaqësuar në gjykim apo për të ngritur padi.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 844/2016 subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me këtë denoncim subjekti, ndër të tjera, në shpjegimet e tij deklaroi se në lidhje me vonesën në zbardhjen e vendimit rezultoi se vendimi është dorëzuar i arsyetuar brenda 4 ditëve të punës, sipas përcaktimeve ligjore. Në lidhje me konstatimin se padia e paditëses N.B nuk është nënshkruar nga paditësja, por është nënshkruar nga avokati i saj në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë i z. I.K, sipas prokurës me nr. ***, datë 22.1.2010, rezultoi se legjitimiteti i djalit I.K, si përfaqësues të paditëses N.B, është verifikuar së pari nga noteri nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila e ka legjitimuar si përfaqësues edhe me vendimin nr.***, datë 15.1.2014, ka shpalljen e moskompetencën lëndore, nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Po kështu, në rigjykimin e kësaj çështjeje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet të njëjtës prokurë, ka vazhduar gjykimin dhe në përfundim ka disponuar me “Pushimin e gjykimin të çështjes, pasi pala paditëse hoqi dorë nga gjykimi”. Denoncuesi I.K nuk është ankuar për faktin pse i është marrë në shqyrtim padia, por për shkelje të procesit dhe veprime korruptive të gjyqtarit. Gjithashtu, fakti se pala paditëse N.K, nëpërmjet djalit të saj I.K, ka hequr dorë nga gjykimi, pas kthimit për rigjykim dhe gjykata ka vendosur pushimin e gjykimin, tregon se ai nuk ka pasur asnjë interes që e drejta e tij të dëgjohet nga një gjykatë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi dhe shqyrtoi dokumentacionin e këtij denoncimi, dëgjoi subjektin në shpjegimet e tij, arsyetoi se: Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në gërmën “ç” të nenit 50 të ligjit nr. 49/2012, i cili përcakton se: *“Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos: ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në rastet kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimin; në nenin 54, pika ‘d’ e këtij ligji përcaktohet se: Gjykata Administrative e Apelit prish vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe ia dërgon çështjen organit kompetent për rigjykim kur: d) gjykata ka shkelur dispozitat lidhur me përfaqësimin e palëve”*.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vijuar gjykimin mbi bazën e një padie, e cila në kuptim të nenit 117 të Kodit të Procedurës Civile është e pavlefshme, pasi nuk është nënshkruar nga paditësja, por nga një avokat i palegjitimuar me prokurë për kryerjen e këtij veprimi. Nga aktet në dosje konstatohen shkelje të rënda procedurale të kryera nga subjekti në gjykimin e kësaj çështjeje dhe, për këto arsye, Gjykata Administrative e Apelit i ka rikthyer çështjet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për t’u gjykuar nga një tjetër trup gjykues.

Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se mungesa e legjitimitetit procedural (*legitimation ad processum*) vlerësohet nga gjykata që në fazën paraprake të procesit, thënë kjo që gjyqtari gjatë kryerjes së seancës përgatitore duhet të verifikojë aktet që kanë të bëjnë me legjitimitetin procedural të palëve dhe në rast të evidentimit të të metave të padisë t’i kthejë aktet palës paditëse dhe t’i caktojë afat për plotësimin e këtyre të metave sipas gërmës “a” të pikës 1 të nenit 25²² të ligjit të posaçëm nr. 49/2012, si dhe nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile.

²²Për zhvillimin e gjykimin, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime: a) I kërkoi paditësit plotësimin e të metave të padisë,

Kryerja e veprimeve të tilla procedurale si përcaktimi i kompetencës tokësore dhe lëndore, zotësia për të vepruar e palëve, legjitimi i palëve dhe përfaqësuesve të tyre janë veprime që lidhen me zhvillimin e procesit të rregull ligjor, në mbrojtje të të drejtave të parashikuara nga dispozitat kushtetuese dhe normat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë (neni 42/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë²³ dhe neni 6/1 i KEDNJ-së²⁴).

6.3. Denoncim nr. * prot., datë 16.5.2022, i shtetasit E.H**

Ky denoncim ndaj subjektit është bërë në lidhje me çështjen gjyqësore nr. ***, numri i aktit ***, datë vendimi 31.8.2021, pasi subjekti ka kryer një proces të parregullt ligjor. Denoncuesi pretendon se subjekti ka vendosur padrejtësisht masën e sigurimit ndaj pronës në emrin e babait të tij dhe këtë vendim e ka marrë në fshehtësi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2022, informon Komisionin se masa e sigurimit të padisë është marrë nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa çështja e themelit është gjykuar nga një gjyqtar tjetër, i cili me vendimin nr. ***, datë 26.10.2021, ka vendosur: Kthimin e akteve dhe kërkesëpadiës. Subjekti ka shqyrtuar masën e sigurimit të padisë me nr. *** akti, datë 31.8.2021 vendimi, dosje e cila pasi është ankimuar, ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Në vendimin e sigurimit të padisë datë 31.8.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: Pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuuesi S.Gj për sigurimin e padisë. Sigurimin e padisë duke urdhëruar Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri, të vendosë kufizimin në kartelën e pasurisë së paluajtshme me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, truall prej 384 m² nga kjo 88 m² ndërtesë, me qëllim mostjetërsimin e kësaj pasurie apo kryerjen e asnjë lloji tjetër veprimi apo transaksioni në të ardhmen nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri deri në përfundimin e këtij gjykimi. Kërkuuesi S.Gj duhet të paraqesë kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 204/2 të Kodit të Procedurës Civile, brenda 10 ditëve nga marrja e këtij vendimi. Ky vendim është marrë pa prezencën e palëve në dhomë këshillimi. Brenda afatit që ka përcaktuar Gjykata kërkuuesi ka paraqitur padi në gjykatë. Me vendimin nr. ***, datë 26.10.2021, gjykata ka vendosur t'i kthejë paditësit kërkesëpadi në bashku me aktet, heqjen e sigurimit të padisë të vendosur datë 31.8.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Nga pjesa arsyetuese e vendimit vërehet se në seancën përgatitore të datës 13.10.2021, gjykata ka konstatuar se kërkesëpadija është paraqitur dhe nënshkruar nga përfaqësuesi i paditësit, z. A.Xh, pajisur me prokurë të posaçme nr. ***, datë 6.9.2012. Kjo prokurë e posaçme ka të përcaktuar tagrat e përfaqësimit të përfaqësuesit, z. A. Xh,

duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë.

Neni 154 i Kodit të Procedurës Civile kur kërkesëpadija nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime. Kodi i Procedurës Civile kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadija quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera. Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm për kthimin e kërkesëpadiës mund të bëhet ankim i veçantë.

²³Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

²⁴Neni 6/1 i KEDNJ-së “E drejta për një proces të rregullt” parashikon: “I. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë”.

por në asnjërën prej tyre nuk përcaktohet vullneti i paditësit për ngritjen e kërkesëpadisë objekt gjykimi prej përfaqësuesit të tij. Në këto kushte i është lënë afat paditësit/përfaqësuesit të tij që të plotësojë aktet e përfaqësimit duke depozituar para gjykatës prokurën e posaçme, e cila legjitimon përfaqësuesin të ngrejë padi dhe ta nënshkruajë atë në emër të paditësit. Paditësit i është lënë një afat prej 13 ditësh. Në datën e caktuar nga gjykata përfaqësuesi i paditësit nuk ka paraqitur prokurën e posaçme që e legjitimon atë të nënshkruajë dhe ngrejë padi, pra pala paditëse nuk ka plotësuar të metat e kërkesëpadisë brenda afatit të caktuar dhe gjykata ka disponuar me kthim aktesh dhe heqjen e sigurimit të padisë²⁵. Kundër këtij vendimi është bërë ankim²⁶. Rezulton nga dosja se edhe vendimi për sigurimin e padisë kërkuesi S.Gj është përfaqësuar në gjykim nga av. A.Xh. Sipas përmbajtjes së prokurës rezulton se përfaqësuesi, av. A.Xh nuk ka pasur tagrin të përfaqësojë z. S.Gj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në lidhje me këtë objekt gjykimi. Nga dosja gjyqësore rezulton se më 17.9.2021 avokati A.Xh ka depozituar një kërkesë me objekt: Plotësimin e të metave të padisë sipas vendimit të datës 9.9.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke i bërë me dije gjykatës se provat në origjinal ku mbështetet kërkesëpadija ndodhen në dosjen nr. *** regj., datë 25.8.2021, me datë vendimi 31.8.2021 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ku ndodhen aktet e depozituara nga paditësi origjinale. I kërkojmë gjykatës që të tërheqë dosjen ose të marri kopje të vendimit dhe ta administrojë se bashku me aktet. Në vendimin “Për sigurim padie datë 31.8.2021 rezulton se kërkuesi S.Gj është përfaqësuar në gjykim nga av. A.Xh sipas prokurës nr. ***, datë 6.9.2012. Gjykata, në gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë, depozituar më 25.8.2021 dhe vendosur masa e sigurimit të padisë në datën 31.8.2021 ka kryer shkelje të rënda procedurale, duke legjitimuar si përfaqësues të kërkuetit S.Gj avokatin A.Xh prokurë e cila nuk i jep avokatit tagrat e përfaqësimit në kërkesën objekt gjykimi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vijuar gjykimin në mungesë të legjitimitit procedural gjë e cila duhet të verifikohet që në fazën paraprake të procesit. Neni 176 i Kodit të Procedurës Civile “Legjitimitimin e palëve në proces” parashikon: *“Gjykata verifikon legjitimitimin si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe kur e sheh të nevojshme, u cakton palëve një afat”*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në shpjegimet e tij, subjekti, ndër të tjera, deklaroi se: *“Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti ka vendosur padrejtësisht masën e sigurimit ndaj pronës në emrin e babait të tij dhe këtë vendim e ka marrë në fshehtësi gjykimi është bërë në një periudhë që, vazhdonin masat shtrënguese për shkak të pandemisë Covid-19. Në lidhje me pretendimin se gjykata ka pranuar për gjykim një kërkesë të nënshkruar nga av. A.Xh, i pajisur me prokurë me nr. ***, datë 6.9.2012, prokurë e cila në asnjë prej tagrave nuk përcakton vullnetin e paditësit S.Gj, për ngritjen e kërkesëpadisë objekt gjykimi. Denoncuesi i është drejtuar edhe institucioneve. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti ka gjykuar një kërkesë me natyrë të posaçme, siç është sigurimi i padisë në dhomë këshillimi mbi bazën e akteve dhe nuk ka verifikuar plotësimin e*

²⁵Neni 39 vendimet jopërfundimtare: “1. Gjykata administrative jep vendime jopërfundimtare vetëm në rastin e mospranimit të padisë dhe të pushimit të gjykimit. 2. Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave. 3. Gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë. 4. Gjykata, me vendimin e saj jopërfundimtar, vendos edhe heqjen e sigurimit të padisë”.

²⁶Neni 31 pika 2 e ligjit nr. 49/2012 parashikon se: *“Ankimi kundër vendimit me të cilin ndryshohet, zëvendësohet ose hiqet masa e sigurimit, pezullon ekzekutimin në tij”*.

kërkesave të përcaktuara nga neni 176 i Kodit të Procedurës Civile dhe kërkesave të parashikuara nga neni 25 i ligjit nr. 49/2012’, parashtroj se: ‘i përfaqësuar S.Gji ka dhënë av. A.Xh, këto tagra: ‘2. Ka të drejtë të më përfaqësojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në gjykatën e apelit, në gjykatën e lartë me objekt: në lidhje me përfitimin e pensionit suplementar si ushtarak, përlllogaritjen e masës së pensionit (suplementit), etj. Në çdo objekt tjetër që e çmon përfaqësuesi. Ka të drejtë të bëjë kërkesë, kërkesëpadi, ankime, rekurse, t’i nënshkruajë, t’i dorëzojë në gjykatë, të shtojë, të pakësojë objektin e padisë ...’, sikurse vihet re i përfaqësuar S.Gj i ka dhënë av. A.Xh tagra për të ngritur kërkesa, kërkesëpadi, ankime, rekurse, t’i nënshkruajë, t’i dorëzojë në gjykatë, të shtojë, të pakësojë objektin e padisë, për çdo objekt tjetër që ai e çmon vetë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në indikatorët e nenit 72 ligjit nr. 96/2016, çmon se mungesa e legjitimitetit procedural (*legitimitio ad processum*) vlerësohet që në fazën paraprake të procesit dhe, në kushte të tilla, gjykata sipas nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile i fton palët të ndreqin të metat e padisë dhe nëse palët nuk i plotësojnë ato atëherë i kthen aktet. Rezulton se subjekti ka gjykuar një kërkesë me natyrë të posaçme, siç është sigurimi i padisë në dhomë këshillimi mbi bazën e akteve dhe nuk ka verifikuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga neni 176 i Kodit të Procedurës Civile dhe kërkesave të parashikuara nga neni 25 i ligjit nr. 49/2012. Trupi gjykues konstaton se këto shkelje procedurale të kryera nga subjekti duhet të kihet parasysh në vlerësimin e aftësive profesionale dhe në vlerësimin tërësor të çështjes.

6.4. Denoncim nr. * prot., datë 10.10.2018, i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare**

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka marrë vendimin nr. ***, datë 30.7.2018, “Për marrjen e masave ndaj shoqërisë së sigurimit “***” sh. a.”. Shoqëria e sigurimit “****” ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar ekzekutimin e aktit administrativ nr. ***, datë 30.7.2018 të AMF-së”. Gjykata administrative e shkallës së parë, me vendimin e datës 3.9.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurisë së padisë, duke pezulluar ekzekutimin e aktit administrativ nr. ***, datë 30.7.2018, të AMF- së. Denoncuesi pretendon se vendimi i gjykatës është marrë në kundërshtim me provat dhe ligjin dhe është dhënë në tejkalim të pretendimeve të palës kërkuese. Sipas AMF-së pezullimi i ekzekutimit të aktit administrativ të AMF-së nga gjyqtari Emiljano Ruli ka dëmtuar rëndë reputacionin e Autoritetit dhe mund të sjellë pasoja në tregun e sigurimeve dhe tregun financiar. Veprimi i kryer nga shoqëria “****” sh.a., në kundërshtim me vendimet e Autoritetit, përbëjnë praktikë të rrezikshme dhe të paqëndrueshme për veprimtarinë e shoqërisë, duke rrezikuar interesat e të siguruarve të cilët kanë lidhur kontratat e sigurimit me këtë shoqëri sigurimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Vendimi i subjektit të rivlerësimit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit, duke dëmtuar rëndë interesat e publikut shqiptar. Marrja e masës ndaj kësaj shoqërie nga AMF-ja lidhet me aftësitë paguese të kësaj shoqërie, që i shërben interesave të të siguruarve, interesa të cilat mund të vazhdojnë të cenohen apo të rrezikohen nga efekti pezullues i këtij vendimi. AMF-ja i ka bashkëlidhur denoncimit kopje të vendimit nr.***regj. them., datë regjistrimi 30.8.2018, datë vendimi 3.9.2018, “Për sigurim padie”.

Komisioni kërkoi informacion mbi këtë çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, ku aktualisht ndodhet çështja për t'u shqyrtuar²⁷. Nga dokumentacioni i dosjes ka rezultuar se:

*Rrethanat e çështjes: në datën 30.8.2018 shoqëria “***” sh.a. ka depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesën me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar aktin administrativ nr. ***, datë 30.7.2018, të AMF-së” deri në gjykimin e çështjes në themel që do të ngrihet nga shoqëria “****” sh.a. brenda afateve ligjore. Kërkesës i janë bashkëlidhur provat, midis të cilave edhe vendimi objekt gjykimi i kërkesës. Me vendimin nr. ***, datë 30.7.2018, “Për marrjen e masave ndaj shoqërisë “***” sh.a.” bordi i AMF-së, pasi ka kontraktuar se shoqëria e sigurimit “****” sh.a., ka vepruar në kundërshtim me vendimin nr. ***, datë 27.10.2017, “Urdhër për eliminim shkeljesh ndaj shoqërisë së sigurimit “***” sh.a.”, ka vendosur:*

i) Bazuar në germen “a”, të pikës 1, të nenit 152, të ligjit nr. 52, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” urdhërohet shoqëria e sigurimit “****” sh.a. të marrë masa për kthimin e fondeve të transferuara në Kosovë dhe të depozitojë në Autoritet dokumentacionin përkatës deri në datën 31.8.2018.

ii) Shoqëria e sigurimit “****” sh.a. të ndalojë dhënien e huave dhe shtesat e kapitalit për palët e lidhura “****” sh.a., “****” sh.a. Kosovë, “****” Kosovë, “****” Maqedoni, si dhe të ndalojë dhënien e huave personave të tretë.

iii) Bazuar në germen “a”, të pikës 1, të nenit 256, të ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit” të sanksionohet me gjobë administratori i shoqërisë së sigurimit “****” në masën 300.000 lekë.

iv) Bazuar në nenin 256 të ligjit nr. 52/2014, Autoriteti paralajmëron shoqërinë e sigurimit për shkarkimin e administratorit të shoqërisë.

Në dosjen gjyqësore ndodhet gjithashtu edhe shkresa nr. *** prot., datë 10.8.2018, e AMF-së, me lëndë “Konstatime nga analiza dhe raportimi i pasqyrave financiare të datës 31.3.2018” me konkluzionet e autoritetit, i cili ka vërejtur nga analiza e pasqyrave financiare se aftësia pagueuse e shoqërisë “****” sh.a. është nën nivelin e kërkuar dhe me treguesit financiarë kjo aftësi do të vijë duke u përkeqësuar. Gjendja e mjeteve monetare në arkë rezulton të jetë ndjeshëm më e lartë se gjendja e mjeteve monetare në llogarinë bankare rrjedhëse të shoqërisë dhe një sërë problematikash serioze që janë konstatuar. Në përfundim AMF-ja kërkon nga shoqëria “****” sh.a.: “*Meqë bordi i AMF-së me vendimin nr. ***, datë 27.10.2017, ka urdhëruar shoqërinë për eliminimin e shkeljeve, të vijohet me zbatimin e kërkesave të vendimit të bordit etj.*”.

- Vendim nr. ***, datë 27.10.2017, “Urdhër për eliminimin e shkeljes ndaj shoqërisë së sigurimit “***” sh.a.” Prapësimet nr. *** prot., datë 31.9.2018, të AMF-së drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Nga dokumentacioni në dosje rezulton se në datën 30.8.2018 është mbajtur procesverbal nga gjyqtari Emiljano Ruli, i cili ka konstatuar se kërkesa është pa të meta dhe ka caktuar datën 3.9.2018 të shqyrtohet çështja në seancë gjyqësore, të thirret si person i tretë AMF-ja dhe të njoftohet edhe avokatura e shtetit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 3.9.2018, ka vendosur “Pranimin pjesërisht të kërkesës duke pezulluar ekzekutimin

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 9.6.2022, e Gjykatës Administrative të Apelit; shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2022, e Gjykatës së Lartë.

e aktit administrativ nr. *** datë 30.7.20178, të AMF-së, si dhe çdo masë tjetër shtrënguese apo mbikëqyrëse që rrjedh nga ky vendim. Rrëzimin e kërkesës në lidhje me kërkimet e tjera”.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2018, ka vendosur “Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. *** akti, datë 3.9.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë” në këtë mënyrë: pranimin e pjesshëm të kërkesës së kërkuësës “***” sh.a.; sigurimin e padisë, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ, vendim nr. ***, datë 30.7.2018, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për masën e marrë me pikën 1 të tij; rrëzimin e kërkesës në lidhje me kërkimin tjetër si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se nga pezullimi i ekzekutimit të masës së marrë në pikën 1 të vendimit nr. ***, datë 30.7.2018, “Për marrjen e masave ndaj shoqërisë së sigurimit “***” sh.a.” nuk cenohet rëndë interesi publik, pasi vlera e shumës që kërkohet të kthehet pranë shoqërisë “***” sh.a. nuk është një vlerë e konsiderueshme dhe nëse do të cenohet rëndë interesi publik AMF-ja do të duhej të kishte marrë masat e përcaktuara germa “a” e pikës 1, të nenit 161 apo atë të përcaktuar në nenin 256 të ligjit nr. 52/2014, masa të cilat nuk rezultojnë se janë marrë prej saj.

Në lidhje me pikat 2 dhe 3 të vendimit, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se nuk provohet ekzistenca e rrethanave dhe kushteve që legjitimojnë marrjen e kësaj mase, pasi ndalimi i dhënies se huave personave të tretë do të sillte pasoja të drejtpërdrejta në uljen e vlerës së aktiviteteve për mbulimin e provigjoneve teknike. Ulja e vlerave të aktivëve për mbulimin e provigjoneve ka të bëjë më aftësinë paguese të shoqërisë, e cila lidhet drejtpërdrejt me interesin publik për shkak të numrit të lartë të të siguruarve. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se nuk provohet ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenin 28 e vijues të ligjit nr. 49/2012²⁸. Nga dokumentacioni në dosje rezultojnë se personi i tretë ka paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe rikthimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit për rigjykim nga një tjetër trup gjykues. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektin iu kërkua të jepte shpjegime në lidhje me këtë denoncim dhe/ose të paraqiste prova për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në shpjegimet e tij, subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Sikurse rezultojnë nga aktet procedurale dhe vendimet gjyqësore, vendimi për sigurimin e padisë është lënë pjesërisht në fuqi nga Gjykata e Apelit, konkretisht për pjesën më të rëndësishme të aktit administrativ, që është urdhërimi i shoqërisë së sigurimit “***” sh.a. të marrë masa për kthimin e fondeve të transferuara në Kosovë dhe të depozitohet në Autoritet dokumentacionin përkatës deri në datën 31.8.2018.*

Po kështu, në lidhje me pikën 2 të aktit administrativ, nëpërmjet vendimit datë 3.9.2018, lidhur me nevojat e sigurimit, kam arsyetuar se nga pala kërkuese në gjykim u provua se vendimi i AMF-së për kthimin e fondeve të transferuara në Kosovë brenda datës 31.8.2018, si dhe bllokimi i gjithë

²⁸Neni 28 “Sigurimi i padisë” parashikon: “1. Me paraqitjen e padisë, paditësi mund t’i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të riparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ. 2. Kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia. 3... 4...”

Neni 29 “Kushtet për sigurimin e padisë” parashikon: “Gjykata vendos sigurimin e padisë nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: (a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresë, për mundësinë e shkakut të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin; (b) nuk cenohet rëndë interesi publik; (c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë”.

*transaksioneve me hua dhe shtesa kapitali brenda grupit mund të shkaktojë kolaps financiar i cili do të çonte në përkeqësimin e pakthyesëm të vetë kompanisë ‘***’ të vendosur në masa mbikëqyrëse. Gjykata, duke iu referuar nenit 29, pika ‘b’ e ligjit nr. 49/2012, çmon se përveç dëmit të rëndë, të pariparueshëm, që do t’i shkaktohej kërkuarit, pezullimi i ekzekutimit të aktit administrativ nuk sjell cenim të rëndë të interesit publik, por e kundërta është e evidente nga provat e paraqitura në gjykim që zbatimi i tij cenon rëndë interesin publik dhe konkretisht sigurinë financiare të qindra mijëra klientëve të siguruar pranë shoqërisë, si dhe sigurinë e qindra punëmarrësve të punësuar pranë shoqërisë mëmë dhe shoqërive të kontrolluara. Kodi i Procedurës Civile dhe ligji nr. 49/2012 u kanë ofruar palëve ndërgjyqëse mjete të posaçme që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas neneve 449, 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve përkatëse në çdo shkallë gjykimi, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Arsytim im është gjetur bindës edhe nga Gjykata e Apelit, e cila e ka lënë pjesërisht në fuqi vendimin e mësipërm. Gjykata e Apelit nuk ka konstatuar asnjë shkelje procedurale në gjykimin e kësaj çështjeje. Për më tepër që shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar akoma, për sa kohë ndodhet në Gjykatën e Lartë”.*

Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në lidhje me këtë denoncim dhe dëgjoi subjektin në shpjegimet e tij, vlerëson se subjekti duhet të demonstrojë aftësi në drejtim të zbatimit të normave procedurale. Plotësimi i kërkesave për vendosjen e masave të sigurimit duhet të bëhet në konformitet me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit të posaçëm nr. 49/2012, si dhe duhet të zbatohet edhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.

Në vendosjen e masës së sigurimit së padisë gjykatat më të ulëta duhet të marrin në analizë të gjitha kushtet themelore të parashikuara nga ligjvënësi për identifikimin e qartë të rrezikut konkret, që i shkakton palës paditëse një dëm të pariparueshëm deri në momentin e shqyrtimit të çështjes me vendim përfundimtar²⁹.

6.5. Denoncim nr. * prot., datë 9.10.2018, i shtetasit L.M**

Ky shtetas denoncon subjektin e rivlerësimit për mungesë profesionalizmi shqyrton çështjen pa u mbështetur në prova, pa bërë hetim të gjithanshëm të rrethanave të çështjes dhe nuk është shprehur për bazën ligjore ku e mbështet vendimin. Denoncuesi i ka bashkëlidhur formularit të denoncimit kopje të kërkesëpadisë me paditës denoncuesin, si dhe kopje të vendimit nr. ***, datë 9.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Nga dokumentacioni i disponuar nga Komisioni vërehej se denoncuesi, bazuar në VKM-në Nr. ***, datë 30.5.2013, ka përfituar të drejtën për të legalizuar ndërtimin pa leje dhe të kalimit në pronësi të parcelës ndërtimore me sip. 124 m² që ka qenë në funksion të ndërtimit që prej 25 vjetësh. Baza ligjore e pretendimeve të denoncuesit është neni 17, pikat 1-6 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006. Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Veri ka nxjerrë

²⁹Vendim nr. ***, datë 10.2.2021, i Kolegjit Civil.

vetëm lejen, duke mos vendosur për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore të pasqyruar në VKM. Pas ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t dhe në KLSH, përgjigjja është se nuk është parë e nevojshme të merret parasysh VKM-ja Nr. ***, datë 30.5.2013. Pas shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se leja e legalizimit e vitit 2015, e nxjerrë në favor të palës paditëse, nuk është bërë asnjëherë objekt i konflikti gjyqësor nga pala paditëse, ku të pretendonte se sipërfaqja prej 124 m², e miratuar me VKM për kalim pronësie, është pjesë funksionale e objektit. Po kështu, në këtë gjykim pala paditëse nuk parashtroi asnjë pretendim se sipërfaqja prej 124 m² e miratuar me VKM për kalim pronësie është pjesë funksionale dhe e domosdoshme për të bërë funksionale objektin e legalizuar.

Komisioni, për nevoja të hetimit, kërkoi informacion pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, nga të cilat iu vu në dispozicion dosja e kësaj çështjeje.

*Nga dokumentacioni i dosjes rezultoi: paditësit L.M dhe Sh.M (vëllezër) kanë plotësuar formularin e vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 24.3.2006, për objektin informal banesë 2 kate, në Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 9482/2006. Paditësit janë pajisur me leje legalizimi për objektin godinë banimi 2 kate me sipërfaqe parcele 200 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 136.6 m². Në vijim, Këshilli i Ministrave, me VKM-në Nr. ***, datë 30.5.2013, ka miratuar për paditësit kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore. Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2016, i përgjigjet shtetasit L.M se: “... nga verifikimi në regjistrin dixhital subjektet L. Sh.M janë pajisur me leje legalizimi nr. *** viti 2015. Nga administrimi i dokumentacionit në dosje gjendet edhe certifikata e pronësisë në emër të L.M dhe Sh.M për truallin me sipërfaqe 200 m². Ndërtimi me sipërfaqe 136.3 m² ndodhet brenda kësaj parcele ndërtimore, për këtë arsye nuk është e nevojshme të merret parasysh VKM-ja Nr. ***, datë 30.5.2013”. Paditësit kanë paraqitur ankim administrativ nr. *** prot., datë 4.4.2016, në Drejtorinë e ALUIZNI-t në lidhje me procedurën e ndjekur në vetëdeklarimin nr. *** të parcelës ndërtimore me nr. ***, z. k. ***, nëpërmjet së cilës parashtrohet se: “... në vitin 2006 paditësit kanë aplikuar me vetëdeklarim për legalizimin e ndërtimit me një sipërfaqe 337 m², ku 200 m² truall janë me certifikatë pronësie dhe pjesa tjetër objekt legalizimi. Në lejen e legalizimit nuk pasqyrohet pronësia që ju njihet me VKM-në Nr. ***, datë 30.5.2013, pasi kjo sipërfaqe është e rrethuar dhe është në shërbim të objektit të vetëdeklaruar për legalizim ...”.*

Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2016, ka sqaruar se nga verifikimi i kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t rezultoi se legalizimi është kryer referuar dokumentacionit të pronësisë, nga ku ka rezultuar se sip. 200 m² disponohet nga ankuesi dhe se ndërtimi i legalizuar me sip. 136.6 m² ndodhet brenda kësaj sipërfaqeje. Paditësit i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Detyrimin e ASHK-së për të kryer veprimet procedurale për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore sipas VKM-së Nr. ***, datë 30.5.2013, në emër të L. e Sh.M. Dhënien e lejes së legalizimit të objektit bashkë me parcelën ndërtimore të pasqyruar në këtë VKM”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. ***, datë 9.12.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se në lidhje me pretendimin që përbën thelbin e kërkesëpadisë bazuar në VKM-në Nr. ***, në pikën 2 është përcaktuar: “Në tabelat që i bashkëngjiten vendimeve, përcaktimi ‘sipërfaqe e parcelës ndërtimore për kalim pronësie’ zëvendësohet me ‘sipërfaqe maksimale e parcelës ndërtimore për kalim pronësie’”. Gjykata, në analizë të përcaktimit të mësipërme të VKM-së Nr. ***, çmon se ALUIZNI, pas kryerjes se procedurave ligjore dhe teknike, ka të drejtë të vlerësojë se sa nga

sipërfaqja maksimale e parcelës ndërtimore për kalim pronësie do të kalojë në pronësi të subjektit vetëdeklarues. Mbi këtë bazë ka vendosur rrëzimin e padisë.

Gjykata Administrative e Apelit ka çmuar që debati gjyqësor është i nevojshëm me qëllim të konstatimit të drejtë të rrethanave dhe fakteve, sipas përcaktimeve të nenit 51 të ligjit nr. *** dhe për këtë arsye ka vendosur të kalojë çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në seancë gjyqësore Gjykata Administrative e Apelit vendosi që sipas nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile të riçelë hetimin gjyqësor, duke administruar prova të reja të paraqitura nga palët, si: vërtetim hipotekor lëshuar nga ZVRPPP-ja Tiranë; kopje të lejes së legalizimit shoqëruar me hartën, skica, kërkesa për legalizim; certifikatë familjare; foto të objektit kartelë pasurie, etj.; aktekspertimi teknik-topografik si provë e marrë në gjykimin në apel. Në përfundim, Gjykata Administrative e Apelit, pasi analizoi provat në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është rrjedhojë e cilësimit jo të drejtë ligjor të mosmarrëveshjes në gjykim në lidhje me kërkimet e padisë, shkakun ligjor të saj dhe provat dhe, për pasojë, ka vend për t'u ndryshuar, duke e pranuar pjesërisht padinë. Gjykata Administrative e Apelit, në analizë të fakteve dhe rrethanave të konkluduara gjatë seancës gjyqësore se veprimet e kryera nga pala e paditur për moskalim në pronësi të parcelës ndërtimore për paditësit vijnë në kundërshtim me ligjin, aktet nënligjore dhe nuk mund të konsiderohen të vlefshme. Palët e paditura nuk kanë zbatuar një akt nënligjor me fuqi detyruese për ta, VKM-në Nr. ***, datë 30.5.2013, "Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale", për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore në emër të paditësve, vendim i cili nuk është konstatuar absolutisht i pavlefshëm, nuk është shfuqizuar dhe as nuk është anuluar nga Këshilli i Ministrave.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ndër të tjera, ka deklaruar se: *"Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për mungesë profesionalizmi dhe se shqyrtoj çështjen pa u mbështetur në prova, pa bërë hetim të gjithanshëm të rrethanave të çështjes dhe nuk është shprehur për bazën ligjore ku e mbështet vendimin', parashtroj se gjatë gjyqimit denoncuesi nuk ka pretenduar asnjëherë kryerjen e një aktekspertimi topografik për të vlerësuar nëse sipërfaqja prej 124 m² kaluar nëpërmjet VKM-së Nr. ***, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë të parcelave ndërtimore nga shteti në favor të poseduesve të objekteve informale', shtrihet apo jo brenda sipërfaqes prej 200 m², të cilën ai e kishte në pronësi dhe mbi të cilën është ndërtuar objekti i legalizuar. Kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave kryhet vetëm në rastet kur trualli nën ndërtim nuk është në pronësi të vetëdeklaruesit ose kur nuk është plotësisht në pronësi të vetëdeklaruesit bëhet kalimi i pronësisë i pjesshëm. Po kështu, edhe në këtë gjykim, pala paditëse nuk parashtroi asnjë pretendim se sipërfaqja prej 124 m², e miratuar me VKM-në për kalim në pronësi, është pjesë funksionale dhe e domosdoshme për ta bërë funksionale objektin e legalizuar. Për më tepër që shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar akoma, për sa kohë gjendet e varur për gjykim në Gjykatën e Lartë, mbi bazën e rekursit të bërë nga Avokati i Shtetit pranë Ministrisë së Drejtësisë, në datën 5.7.2021, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë".*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në dokumentacionin e administruar për këtë çështje, konstaton se gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është bërë bazuar në rregullin e përgjithshëm të parashikuar nga neni 49 i ligjit të posaçëm nr. 49/2012, por çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore në praninë e palëve. Bazuar në neni 51/1 të ligjit nr. 49/2012, gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm, për të vlerësuar se:

- a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji;
- b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;
- c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka zbatuar drejt ligjin procedural dhe ligjin material dhe ka shfaqur mangësi në drejtim të interpretimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit material. Këto kontraktime do të mbahen në konsideratë në vlerësimin përfundimtar në lidhje me kriterin profesional.

6.6. Denoncim nr. * prot., datë 10.7.2018, i shtetasit B.C**

Ky shtetas ankohet për vendim të padrejtë nga ana e subjektit, paaftësi profesionale, shkelje të procesit të rregullt ligjor, duke mos i dhënë palës paditëse të drejtën për të marrë prova dhe shkelje të parimit të paanësisë dhe ligjshmërisë, duke i sjellë denoncuesit një dëm të madh moral dhe financiar. Denoncimit i ka bashkëlidhur dosjen e çështjes me palë paditëse B.C, i paditur Komisioni i Disiplinës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit për ‘largim nga shërbimi civil’”. Subjekti, me vendimi nr. ***, datë 11.11.2014, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë të paditësit B.C”. Denoncuesi pretendon se subjekti ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese, nuk ka kryer fare hetim në mbledhjen e fakteve dhe shqyrtimin e drejtë të çështjes dhe nuk i ka dhënë mundësinë e kryerjes së aktit të ekspertimit. Rrethanat dhe faktet e prezantuara nga denoncuesi çojnë në *indicie* dyshuese në lidhje me vendimmarrjen e subjektit. Për një vlerësim objektiv të çështjes është tërhequr dosja e vendimit nr. ***, datë 11.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga ku ka rezultuar se kjo vendimmarrje e subjektit është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit.

Komisioni, bazuar në të dhënat e disponueshme në lidhje me këtë çështje, konstaton se gjykimi në Apelin Administrativ nuk është bërë bazuar në rregullin e përgjithshëm të parashikuar nga neni 49 i ligjit të posaçëm nr. 49/2012, por çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore në praninë e palëve. Bazuar në neni 51/1, gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

- a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji;
- b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;
- c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë.

Rezultoni se në Gjykatën e Apelit është riçelur pjesërisht hetimi dhe është administruar si provë aktekspertimi, nga ku rezultoni e provuar pretendimi i paditësit B.C për falsitetin e aktit të konstatimit nr. *** serial, datë 21.3.2014, për sa i përket mungesës së nënshkrimit nga ana e tij. Pavarësisht së vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit është e njëjtë me vendimmarrjen e subjektit, konstatohet se në zgjidhjen e çështjes subjekti nuk ka kryer veprime procedurale për të konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, si p.sh. moskryerja e aktekspertimit për të verifikuar falsitetin e aktit të konstatimit datë 21.3.2014.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Në lidhje me denoncimin se ‘për vendim të padrejtë nga ana e subjektit, paaftësi profesionale, shkelje të procesit të rregullt ligjor, duke mos i dhënë palës paditëse të drejtën për të marrë prova; shkelje të parimit të paanësisë dhe ligjshmërisë, duke i sjellë denoncuesit një dëm të madh moral dhe financiar’, sikurse rezultoni nga aktet e dosjes së procesit të rivlerësimit dhe vendimet gjyqësore, shtetasi B.C, në cilësinë e palës paditëse, gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk ka pretenduar asnjëherë kryerjen e aktekspertimit për të verifikuar falsitetin e aktit të konstatimit datë 21.3.2014. Sikurse rezultoni, paditësi, as në padi, as në prapësime, por as në konkluzionet përfundimtare, nuk e ka pretenduar asnjëherë kryerjen e aktekspertimit. Gjykata Administrative e Apelit ka riçelur hetimin gjyqësor, duke pranuar të administrojë si provë aktekspertimin grafik nr. ***, datë 28.5.2015, të kryer nga Drejtoria e Policisë Shkencore, mbi bazën e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër. Aktekspertimi grafik nr. ***, datë 28.5.2015, i kryer nga Drejtoria e Policisë Shkencore, mbi bazën e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, nuk ishte formësuar akoma si provë në datën 11.11.2014, ku është dhënë vendimi nr. ***, datë 11.11.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ndërkohë, ky pretendim është ngritur në gjykimin në apel sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012³⁰. Për më tepër (sipas akteve të dosjes së procesit të rivlerësimit) që aktekspertimi grafik nr. ***, datë 28.5.2015, pasi është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Apelit, është vlerësuar se nuk përputhet me provat e tjera dhe, për pasojë, konkluzionet e tij nuk janë vlerësuar si relevante, duke çuar kështu në të njëjtin konkluzion me gjykatën e shkallës së parë, në rrëzimin e padisë.*

Përveç sa më sipër, shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar akoma, dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se: ‘Pavarësisht së vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit është e njëjtë me vendimmarrjen e subjektit, konstatohet se në zgjidhjen e çështjes subjekti nuk ka kryer veprime procedurale për të konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, si p.sh. moskryerja e aktekspertimit për të verifikuar falsitetin e aktit të konstatimit datë 21.3.2014’, po parashtrij se shtetasi B.C, në cilësinë e palës paditëse, gjatë gjykimit në shkallë të parë, nuk ka pretenduar asnjëherë kryerjen e aktekspertimit për të verifikuar falsitetin e aktit të konstatimit datë 21.3.2014. Sikurse rezultoni, paditësi, as në padi, as në prapësime, por as në konkluzionet përfundimtare, nuk e ka pretenduar asnjëherë kryerjen e aktekspertimit.

³⁰Paraqitja e provave të reja: në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

Në gjykimin civil, por edhe atë administrativ, roli aktiv i gjykatës është i limituar dhe i kufizuar vetëm në aspektin formalo-procedural të verifikimit të kushteve formale të paraqitjes së padisë (neni 14-19 i ligjit nr. 49/2012), si dhe në verifikimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme (neni 161 i Kodit të Procedurës Civile), por kurrësi gjykata nuk mund të marrë rol aktiv në përcaktimin dhe mbledhjen e provave, për të vërtetuar faktet e pretenduara nga palët ndërgjyqëse (përveç rasteve të përcaktuara në nenet 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile, marrja e provave të tretët ose organet e administratës publike)”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se përtej përcaktimeve të palës paditëse në kërkesëpadi, bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile³¹ dhe vendimin unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: “Gjykata zbulon shkakun e padisë së paditësit duke analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar në dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadi së del e qartë e drejta që kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen komfor shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadi së, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohet prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon që janë cenuar”. Gjyqtari nuk duhet të harrojë parimin që gjyqtari e njeh ligjin dhe duhet t’i japë një zgjidhje të drejtë çështjes që ka për të gjykuar.

Në Komision janë depozituara edhe 17 denoncime të tjera, të cilat u shqyrtuan nga trupi gjykues dhe u arrit në konkluzionin se nuk përmbushin kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, pasi analizoi si më sipër denoncimet sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti, vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka kompetencë të gjykojë mbi themelin e çështjeve, tagra këto në kompetencë të një gjykate më të lartë dhe duke mbajtur në konsideratë edhe vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, vlerëson se shkeljet e konstatuara nuk janë në masën që të merren në konsideratë si shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, zhvilloi seancat dëgjimore publike, mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti

³¹Neni 16 i Kodit të Procedurës Civile: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës”.

i rivlerësimit, arrin në përfundimin se bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 29.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka

